

Publikationen zur rechtlichen Zusammenarbeit

Buletini i praktikës gjyqësore të GJEPD

Buletini i praktikës gjyqësore të
Gjykatës Evropiane për të drejtat e
njeriut

IRZ

Publikationen zur rechtlichen Zusammenarbeit 2015

1992 — 1997 — 2002 — 2007 — 2012 — 2015



Makavej, 2015

botuar nga
Enti për përfaqësim të Republikës së
Maqedonisë para GJEPD
dhe
Fondacioni gjerman për bashkëpunim
ndërkombëtarë juridik, Shoqatë e
regjistruar (IRZ)



Republic of Macedonia
Ministry of Justice
Republika e Maqedonisë
Ministria e Drejtësisë

FONDACIONI GJERMAN PËR
BASHKËPUNIM NDERKOMBËTARË
JURIDIK



Stabilitätspakt für Südosteuropa
Geördert durch Deutschland
Stability Pact for South Eastern Europe
Sponsored by Germany

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Botues:

MAKAVEJ Shkup, viti 2015

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Koço Bendo

Behar Dalipi

Koordinimi i redaksisë së edicionit në gjuhën maqedonase: Dr. Shtefan Pirner, avokat dhe mr. Kostadin Bogdanov, v.d. Drejtor i Entit për përfaqësim të RM-së para GJEDNJ – Agjent i Qeverisë.

Bashkëpunimi i redaksisë së edicionit në gjuhën maqedonase: Dragana Radisavlleviq, jurist i diplomuar me provimin e dhënë të judikaturës dhe Dana Trajçev – Bozhiq, V.A., studime për media dhe komunikime.

Përkthimi i këtij Buletini në gjuhën shqipe, si dhe botimi i këtij publikimi u mundësua nga ana e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ndërkombëtarë juridik, shoqatë e regjistruar (IRZ) me mjete nga kontributi gjerman i dedikuar për Paktin për stabilitet të Evropës Juglindore.

Të nderuar kolegë dhe kolege, Të dashur lexues,

Në duart tuaj po e mbani buletin e parë i cili i kushtohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, i cili do të botohet në bashkëpunim me z. Kostadin Bogdanov, agjent qeveritar dhe drejtor i Entit për përfaqësim të Maqedonisë para GJEDNJ, dhe Fondacionit Gjerman për bashkëpunim ndërkombëtarë juridik (IRZ). Për këtë arsye botuesit shkurtimisht do të elaborojnë qëllimin e këtij publikimi të ri dhe shkaqet për botimin e përbashkët të saj.

Rëndësia e KEDNJ së pari për organet dhe gjykatat kombëtare

Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut u zhvillua si një instrument i rëndësishëm për të drejtat e shteteve – anëtare të Këshillit të Evropës. Si rezultat i kësaj, praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut u shndërrua si një udhëzues i rëndësishëm për synimet e përbashkëta të të gjitha shteteve anëtare të Këshillit të Evropës për evitimin e shkeljeve të drejtave të njeriut. Aktgjykimet e Gjykatës në Strasburg janë miratuar për raste të veçanta që kanë të bëjnë me shtete të caktuara. Njëkohësisht ato demonstrojnë edhe parimet të cilat duhet ti respektojnë të gjitha shtetet – anëtare të Këshillit të Evropës. Në rastin tonë me nocionin “shtete” nuk nënkuptohen vetëm qeveritë, por edhe të gjithë që punojnë pranë organeve të ndryshme shtetërore, dhe kjo para se gjithash ka të bëjë me drejtoritë e ndryshme dhe gjykatësit e përfshirë në të gjitha gjykatat shtetërore. Saktë për të njëjtit, aktgjykimet e sjella nga GJEDNJ paraqesin një pikë të rëndësishme të orientimit. Nga njëra anë, ato ndihmojnë gjatë interpretimit të dispozitave ligjore kombëtare, kurse nga ana tjetër, ato paraqesin obligime për gjykatat në nivele kombëtare, që të njoftohen dhe ti respektojnë aktgjykimet e sjella nga Gjykata në Strasburg.

Botuesit e këtij buletini

Për këtë arsye, informacionet për këtë praktikë gjyqësore, paraqesin një detyrë që është në interes si për shtetet e caktuara, ashtu edhe për të gjitha

shtetet - anëtare të Këshillit të Evropës. Megjithatë, ato paraqesin edhe një pikë të rëndësishme në suaza të bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë. Duke pasur këtë parasysh, bëhet i qartë edhe bashkëpunimi në mes agjentit qeveritarë maqedonas para Gjykatës në Strasburg dhe Fondacionit gjerman për bashkëpunim ndërkombëtarë juridik, shoqatë e regjistruar (IRZ).

Agjenti qeveritar

Agjenti qeveritar, udhëheq me Entin për përfaqësim të Republikës së Maqedonisë para Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, që paraqet organin e drejtorisë shtetërore në përbërjen e Ministrisë për drejtësi e cila i kryen detyrat që kanë të bëjnë me përfaqësimin dhe procedimin e Republikës së Maqedonisë para Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut. Përskaft faktit që në mënyrë të drejtpërdrejtë e përfaqëson Republikën e Maqedonisë në procedurat para Gjykatës, Enti gjithashtu është kompetent për realizimin e analizave permanente të aktgjykimeve dhe praktikës së Gjykatës në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, që janë të garantuara me Konventën Evropiane për mbrojtjen e drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe për këtë i njofton gjykatat vendore dhe organet shtetërore, përpilon rekomandime për procedime të mundshme të gjykatave vendore dhe të organeve shtetërore me qëllim të përmbartimit të vendimeve të sjella nga Gjykata, në rastet kur janë konstatuar shkelje të Konventës nga ana e gjykatave vendore dhe organeve shtetërore, të kujdeset për sigurimin e harmonizimit të legjislativit vendor me standardet e Konventës dhe praktikës së Gjykatës si dhe të siguroj bashkëpunimin me Akademinë për trajnim të gjykatësve dhe prokurorëve publik dhe të zëvendësve të tyre, për edukim permanent të gjykatësve, prokurorëve publik, avokatëve dhe profesioneve tjera juridike, me qëllim të përmbartimit të aktgjykimeve dhe zbatimit të praktikës së Gjykatës si burim i drejtësisë.

IRZ

IRZ është themeluar në vitin 1992, me iniciativë të ministritë federal për drejtësi të asaj kohe dr. Klaus Kinkel me qëllim të vetëm, që në urdhër të qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë tu ofroj përkrahje ish shteteve socialiste në fazë të tranzicionit, gjatë ri rregullimit të sistemit të tyre juridik.

Ajo është aktive në fushën e këshillimeve ligdhënëse, trajnimin e juristëve si dhe për botimin e publikimeve nga fusha e drejtësisë. Për momentin, IRZ është aktive në pothuajse 30 shtete, në mesin e të cilave janë edhe disa shtete nga Azia dhe Afrika e Veriut. Në Evropën Juglindore, vepron nga viti 2000 me mjetet e Ministrisë për punë të jashtme të RF Gjermanisë si pjesë e kontributit të Gjermanisë për Paktin për stabilitet të Evropës Juglindore. Në këto korniza, IRZ në Maqedoni ka shumë pika të përbashkëta me veprimtarinë e agjentit qeveritarë.

Nga njëra anë, IRZ tani më katër vite me radhë realizon botimin e revistës “E drejta Evropiane”, në të cilën gjithashtu haset rubrika “Të drejtat Evropiane të njeriut dhe praktika gjyqësore në GJEDNJ” (Të gjitha edicionet e kësaj reviste mund ti gjeni në ueb faqen www.evropskopravo.info dhe të njëjtit mund ti merrni në trajtë të dokumenteve PDF në fushën „Download” të ueb faqes së IRZ www.irz.de. Për lexuesit që flasin gjuhën gjermane, këtu mund të gjenden edhe versionet e shkurtra të revistës në gjuhën gjermane. Të njëjtit përfshijnë parathënien, përmbajtjen dhe rezymetë e çdo artikulli, ashtu që edhe pa njohjen e gjuhës maqedonase, mund të përfitohet një pasqyrë për përmbajtjen e revistës dhe zhvillimin e saj). Nga ana tjetër, IRZ tani më disa vite me radhë, realizon bashkëpunim me Seksionin për informacione publike dhe për publikime lidhur me praktikën gjyqësore pranë Gjykatës në Strasburg, gjatë shpalljes së publikimeve në lidhje me KEDNJ dhe për praktikën e GJEDNJ në gjuhë të ndryshme që fliten në Evropën Juglindore. Në fillim të vitit 2015 edhe në shënimet informative për praktikën gjyqësore të Gjykatës, ky bashkëpunim u vlerësua si një shembull i shkëlqyer për përkrahjen e punës së Gjykatës. (Raporti i shënimit informues mund të merret në ueb faqen e IRZ më saktë në <http://irz.de/en/macedonia>.) Edhe në Republikën e Maqedonisë, IRZ ka një traditë të gjatë në fushën e KEDNJ. Përkaj kësaj, ajo ka përfituar përvoja të shumta gjatë bashkëpunimit me gjykatësit dhe prokurorët publik nga Maqedonia. Për këtë grup të dëgjuesve, nga viti 2007 në bashkëpunim me Akademinë për gjykatësit dhe prokurorët publik, me rregull janë realizuar seminare në tema të ndryshme.

Përmbajtja dhe qëllimi i këtij buletini

Pas hyrjes së lartpërmendur nga ana e botuesve, nuk nevojiten arsyetime plotësuese për motivet e tyre për tu përcaktuar që në periudha të sakta

kohore të njoftojnë opinionin juridik dhe të gjerë maqedonas për praktikën gjyqësore të Gjykatës në Strasburg si dhe për tema tjera aktuale në lidhje me KEDNJ.

Njoftimi do të realizohet në trajtën e buletineve të botuar në gjuhën maqedonase, që në formë koncize parimisht do të njoftojnë për tema që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtësisë maqedonase. Buletini, para se gjithash do të shpërndahet në formë elektronike. Në këtë mënyrë do të gjenerohet një medium aktual i cili pa prolongime do të njoftoj dhe do të jetë falas për adresantët.

Numri i parë ka të bëjë vetëm me aktgjykimet e GJEDNJ. Megjithatë për edicionet e ardhme, lexuesit sinqerisht do të ftohen që ti dorëzojnë edhe kontributet e tyre. Këtu mund të përfshihen punime të shkurtra shkencore në temat që kanë lidhje me KEDNJ, komentet lidhur me aktgjykimet e GJEDNJ, por edhe raporte lidhur me evenimentet e mbajtura për temat nga fusha e të drejtave të njeriut ose prezantime të publikimeve me tema të ngjashme.

Falënderime të përzemërta

Botuesit e këtij buletini, agjenti qeveritar maqedonas z. Kostadin Bodganov dhe IRZ-ja gjermane, e shfrytëzojnë rastin që ti falënderohen të gjithë atyre që e mundësojnë veprimtarinë e tyre, dhe me këtë, në instancë të fundit edhe botimin e këtij buletini.

Në anën e agjentit qeveritarë, janë të punësuarit pranë Entit për përfaqësim të Republikës së Maqedonisë para Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, të cilët me sakrificë dhe përkushtim po orvaten dhe punojnë për promovimin e praktikës gjyqësore dhe parimet e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë si dhe për edukimin e gjykatësve dhe prokurorëve publik në këtë fushëveprim.

Fusha projektuese e IRZ për Maqedoninë, nga njëra anë, do të doja që përzemërsisht ti falënderohen Ministrisë për punë të jashtme të RF Gjermanisë. Tani më një dekadë e gjysmë, me mjetet nga kontributet gjermane të dedikuara për Paktin për stabilitetin të Evropës Juglindore, këtë po e mundëson veprimtaria e IRZ në Maqedoni dhe bashkëpunimi i suksesshëm me partnerët e atyre vendeve. Nga ana tjetër, u drejtojmë falënderime edhe Ministrisë federale të Gjermanisë për drejtësi dhe për

mbrojtjen e shpenzuesve (BMJV) për përkrahje të IRZ dhe të aktiviteteve të saja në Evropën Juglindore. Në vend të ngjarjes, këtu në Shkup, falënderime të singerta u drejtojmë edhe ambasadorit të Gjermanisë dr. Kristine D. Allthauzer dhe të gjithë paraardhësve të saj, të cilët së bashku me të punësuarit në ambasadën e Gjermanisë, me kujdes dhe në mënyrë konstruktive e përcollën dhe po e përcjellin punën e IRZ në Maqedoni.

Z. Kostadin Bogdanov

*Agjent qeveritar dhe drejtor i
Entit për përfaqësim të Maqedonisë
Pranë GJEDNJ*

Dr. Shtefan Pirner

*Drejtues i fushës projektuese
Bosnje dhe Hercegovina, Maqedonia,
Mali i Zi dhe Serbia pranë IRZ*

Të nderuar kolegë dhe kolege gjykatës,

Me këtë rast, do të doja që përzemërsisht ta përshëndes projektin e ri për botimin e Buletinit të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, botimi i të cilit është iniciuar nga ana e Fondacionit Gjerman për bashkëpunim ndërkombëtarë juridik (IRZ) dhe Entit për përfaqësim të Maqedonisë para GJEDNJ

Siç është e njohur, më 10 prill të vitit 1997, Republika e Maqedonisë e ratifikoi Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore. Prej atëherë, gjatë pothuajse dy dekadave, jemi dëshmitarë të zhvillimit të hovshëm të praktikës gjyqësore të Gjykatës në Strasburg në raport me shtetin tonë. Numri i madh i aplikimeve, si dhe numri i zmadhuar i aktgjytimeve të sjella nga Gjykata, nëpërmjet të cilëve adresohen një numër i madh i çështjeve lidhur me interpretimin dhe zbatimin e drejtësisë vendore, por para se gjithash në kontekstin e interpretimeve dhe zbatimit të Dispozitave dhe të standardeve të Kopenhagës nga ana e gjykatave vendore, gjithnjë e më tepër po e imponojnë nevojën për përcjelle të fuqizuar dhe të vazhdueshme si dhe për inkorporimin e tyre gjatë procesit të zbatimit të drejtësisë në Republikën e Maqedonisë.

Edhe më tepër, Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut si Marrëveshje ndërkombëtare dhe Protokollet përcjellëse, në pajtim me nenin 118 të Kushtetutës, paraqesin pjesë përbërëse të rendit ligjor të shtetit dhe të njëjtit mund të konsiderohen edhe si burim i drejtësisë, në bazë të cilit duhet të mbështeten të gjitha vendimet e gjykatave vendore. Duke u nisur nga fakti se Konventa është jetësuar dhe se esenca e saj po manifestohet përmes interpretimeve të saja, të përfshira në aktgjykimet dhe vendimet e sjella nga GJEDNJ, dhe në pajtim me qasjen dinamike dhe evoluese të interpretimit të tyre, si e domosdoshme po shfaqet nevoja që gjykatësit maqedonas nga të gjitha instancat, me përkushtim dhe vazhdimisht ti përcjellin trendët e reja dhe ndryshimet në zhvillimin e praktikës së GJEDNJ në fushat dhe për çështjet të cilat i trajtojnë gjatë punës së tyre të përditshme. Me këtë, ata do të përcillnin hapin me qëndrimet më të reja të marra nga ana e Gjykatës në lidhje me çështje të caktuara dhe do të mund të njëjtit ti marrin parasysh më me seriozitet gjatë vendosjes së tyre në nivel kombëtarë, me këtë do të

kontribuohet për anulim të përshpejtuar të shkeljeve të mundshme në të ardhmen mbi të drejtat dhe liritë e garantuara me Konventën si dhe për zvogëlimin e numrit të aplikimeve dhe aktgjykimeve të GJEDNJ në të cilat do të konstatohen shkeljet eventuale të Konventës nga ana e Republikës së Maqedonisë. Saktë në këtë mënyrë, gjykatësit nga Maqedonia, si arbitër final gjatë zgjidhjes së situatave konfliktuozë dhe si bartës të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, do të luajnë rolin esencial në procesin e harmonizimit të praktikës gjyqësore vendore me parimet dhe standardet e Konventës dhe me qëndrimet e Gjykatës të reflektuara përmes praktikës së saj të pasur dhe të llojllojshme gjyqësore.

Gjykatësit maqedonas, tani më kanë bërë orvatje të shumta që të jenë në hap me jurisprudencën e GJEDNJ, si një prej mekanizmave më efikase për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe ti respektojnë rregullat e implementuara dhe standardet gjatë sjelljes së aktgjykimeve kundër Republikës së Maqedonisë, me qëllim të evitimit të përsëritjes së shkeljeve të njëjta, që të sigurohen garanci për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të garantuara me Konventën dhe me Kushtetutën e shtetit, si dhe të rikthejë renomenë dhe autoritetin e gjykatave vendore si shtylla të sistemit të sundimit të ligjit. Prapëseprapë, jemi të vetëdijshëm për nevojën për përsosje të vazhdueshme, por edhe për sendërtimin e përvojave tona pozitive në këtë drejtim.

Njëkohësisht, ishte e dukshme mungesa e mjeteve të cilat do të mundësonin përafrimin e praktikës së Gjykatës deri te gjykatësit në Maqedoni në një mënyrë e cila është e lehtë për qasje. Saktë për këtë arsye, botimi i këtij Buletini të praktikës gjyqësore të GJEDNJ, i cili njëkohësisht do të shtjellojë edhe tema lidhur Konventën dhe funksionimin e Gjykatës në Strasburg do të mundësojë zgjerim të konsiderueshëm të njohurive mbi Konventën dhe praktikën gjyqësore të gjykatësit tanë, si dhe ndarjen periodike të informacioneve në këtë fushëveprim, me këtë do të lehtësohet dhe ndihmohet edhe implementimi kombëtarë e KEDNJ nga ana e gjykatave në Republikën e Maqedonisë. Jo më pak i rëndësishëm është fakti, nëse shfaqet interesimi për këtë gjë, edhe gjykatësve tanë do të ju ofrohet mundësia që të marrin pjesë me punimet dhe analizat e tyre në procesin formulimit të edicioneve të ardhme të këtij Buletini të rëndësishëm nga fusha e drejtësisë, me të cilin plotësohet një boshllëk i madh krahas shpalljeve të llojit të tillë të artikujve profesionale.

Në bazë të lartpërmendurës, do të doja që edhe një herë të shpreh falënderimet e mira për iniciativën për botimin e Buletinit, iniciativë kjo e marrë nga IRZ, dua të shpreh përkrahjen time të plotë për të njëjtin, si dhe të Ju ftoj të gjithë Ju, të nderuar kolegë, që përmes shfrytëzimit të këtij Buletini si mjet për përafrimin drejtë praktikës juridike Konvencionale si dhe përmes zbatimit të diturive të përfituara në Gjykatën tuaj, të kontribuoni për harmonizimin e praktikës vendore gjyqësore me standardet evropiane në sferën e të drejtave të njeriut.

Zonja Lidija Nedellkova

Kryetar i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë

Përmbajtja

Parathënia e botuesve	3
Parathënia e zonjës Lidija Nedellkova, Kryetar i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë	8

I. AKTGJYKIMET MË TË REJA TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

<i>Atajkaja (Ataykaya) kundër Turqisë</i> - A. nr. 50275/08 Aktgjykimi i datës 22.7.2014 [Seksioni II]	13
<i>Anxhello Georgiev (Anzhelo Georgiev) dhe të tjerët kundër Bullgarisë</i> - A. nr. 51284/09 Aktgjykimi i datës 30.9.2014 [Seksioni IV]	16
<i>Liapin (Lyapin) kundër Ruisë</i> - A. nr. 46956/09 Aktgjykimi i datës 24.7.2014 [Seksioni I]	17
<i>Ereren (Ereren) kundër Gjermanisë</i> - A. nr. 67522/09 Aktgjykimi i datës 6.11.2014 [Seksioni V]	19
<i>Licejtceva dhe Masllov (Liseytseva and Maslov) kundër Ruisë</i> - A. nr. 39483/05 dhe 40527/10 Aktgjykimi i datës 9.10.2014 [Seksioni I]	21
<i>Hornkastll (Horncastle) dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar</i> - A. nr. 4184/10 Aktgjykimi i datës 16.12.2014 [Seksioni IV]	23
<i>Bajtar (Baytar) kundër Turqisë</i> - A. nr. 45440/04 Aktgjykimi i datës 14.10.2014 [Seksioni II]	26
<i>Cvetelin Petkov (Tsvetelin Petkov) kundër Bullgarisë</i> - A. nr. 2641/06 Aktgjykimi i datës 15.7.2014 [Seksioni IV]	27
<i>Hamalainen (Hämäläinen) kundër Finlandës</i> - A. nr. 37359/09 Aktgjykimi i datës 16.7.2014 [GC]	29

<i>Xhemuik (Dzemyuk) kundër Ukrainës</i> - A. nr. 42488/02 Aktgjykimi i datës 4.9.2014 [Seksioni V]	31
<i>Aksell Shpringer AD (Axel Springer AG) kundër Gjermanisë (nr. 2)</i> - A. nr. 48311/10 Aktgjykimi i datës 10.7.2014 [Seksioni V]	33
<i>Matuz (Matúz) kundër Hungarisë</i> - A. nr. 73571/10 Aktgjykimi i datës 21.10.2014 [Seksioni II]	35
<i>Couderc and Hachette Filipacchi Associés kundër Francës</i> - A. nr. 40454/07 Aktgjykimi i datës 12.6.2014 [Seksioni V]	36
<i>A. B. (Bedat)(A.B. (Bedat)) kundër Zvicrës</i> - A. nr. 56925/08 Aktgjykimi i datës 1.7.2014 [Seksioni II]	37
<i>Navalni dhe Jashin (Navalnyy and Yashin) kundër Rusisë</i> - A. nr. 76204/11 Aktgjykimi i datës 4.12.2014 [Seksioni I]	38
<i>Abufada (Aboufadda) kundër Francës</i> - A. nr. 28457/10 Vendimi i datës 4.11.2014 [Seksioni V]	40
<i>Llaki Dev (Lucky Dev) kundër Suedisë</i> - A. nr. 7356/10 Aktgjykimi i datës 27.11.2014 [Seksioni V]	42

II. AKTGJYKIME MË TË VJETRA TË RËNDËSISHME TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

<i>Rasti Gucanovi (Case of Gutsanovi) kundër Bullgarisë</i> - A. nr. 34529/10 Aktgjykimi i datës 15 tetor 2013	45
--	----

III. AKTGJYKIME KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

<i>III.1 Kitanovski kundër RM-së</i> - A. nr. 15191/12 (Aktgjykimi i GJEDNJ i datës 15 janar të vitit 2015)	51
<i>III.2 Familja Mitovi kundër RM-së</i> - A. nr. 53565/13 (Aktgjykimi i GJEDNJ i datës 16 prill të vitit 2015)	59
<i>III.3 Mitrinovski kundër RM-së</i> - A. nr. 6899/12 (Aktgjykimi i GJEDNJ i datës 30 prill të vitit 2015)	63

I. VENDIME TË FUNDIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

NENI 2

Përdorimi i forcës

Plagosje fatale e shkuar nga bombat gaz lotsjellës të hedhura nga anëtarët e forcave të sigurisë të veshura me maska: *shkelje*

Ataykaya kundër Turqisë - 50275/08

Vendimi 22.7.2014 (Seksioni II)

Faktet – Në mars të vitit 2006, ndërsa kërkuesi po largohej nga vendi i tij i punës, i biri i tij u gjet në mes të një demonstrate dhe u godit në kokë nga një prej disa bombave gaz lotsjellës të hidhura nga forcat e sigurisë. Ai vdiq disa minuta më vonë. U zhvilluan hetimet administrative dhe penale, por ato nuk mundën të identifikonin personin i cili kishte bërë gjuajtjen fatale.

Ligji – Neni 2 (*pjesët lëndore dhe procedurale*)

Është vërtetuar tej dyshimit të arsyeshëm që një anëtar i forcave të sigurisë ka gjuajtur të birin e kërkuesit duke përdorur një hedhës të bombave me gaz lotsjellës, duke e plagosur atë në kokë dhe duke i shkuar vdekjen. Pas ankesës së bërë nga kërkuesi në mars 2006 nisi një hetim por ai ishte problematik në shumë aspekte. Së pari, hetimet policore dhe administrative nuk mundën të identifikonin – dhe, për pasojë, të merrnin në pyetje – anëtarin e forcave të sigurisë që kishte realizuar gjuajtjen fatale, për shkak se fytyra e tij ishte i mbuluar me maskë. As autoritetet hetimore nuk ishin në gjendje të eidentonin me siguri se sa anëtarë të forcave të policisë ishin autorizuar të përdornin këtë lloj arme në momentin e incidentit. Për më tepër, zyra e prokurorisë kishte marrë në pyetje vetëm disa anëtarë të forcave të sigurisë, ndërsa ekzistonte mungesë bashkëpunimi nga ana e autoriteteve policore me zyrën e prokurorisë përgjegjëse për hetimin; kjo ishte veçanërisht e pashpjegueshme duke ditur rolin e kësaj të fundit në marrjen e informacionit zyrtar nga një agjenci shtetërore. Si rezultat i vendimit për të veshur maska, punonjësit e policisë përgjegjës për gjuajtjet faktikisht kishin

marrë imunitet ndaj ndjekjes penale. Për shkak të maskave, ka qenë e pamundur për dëshmitarët okularë të identifikojnë punonjësin e policisë që ka qëlluar të birin e kërkuesit, dhe gjithashtu e pamundur të merreshin në pyetje si dëshmitarë ose si të dyshuar të gjithë punonjësit e policisë që kishin përdorur hedhësit e bombave. Fakti që dëshmitarët okularë – të cilët për shkak të maskave - nuk ishin në gjendje të identifikonin punonjësin përgjegjës për gjuajtjen fatale në vetvete është shqetësuese. Në rastet kur autoritetet kompetente të brendshme angazhojnë punonjës policie me maska për të ruajtur rendin publik ose të kryejnë arrestime, këta punonjës duhet të mbajnë një shenjë identifikuese – si një numër identifikimi – i cili, duke ruajtur anonimitetin, mund ta bënte të mundur identifikimin e tyre për marrjen në pyetje nëse ndaj zhvillimit të operacionit më vonë do të bëhej ankim. Kështu, autoritetet e brendshme qëllimisht kishin krijuar një situatë padënueshmërie, që kishte parandaluar identifikimin e punonjësve të policisë që dyshoheshin për hedhjen e bombave gaz lotsjellës pa kujdesinë duhur, përcaktimin e përgjegjësive të punonjësve të lartë dhe zhvillimin e një hetimi të efektshëm. Përveç kësaj ishte shqetësuese që në regjistrat policorë nuk ishte përfshirë asnjë informacion në lidhje me incidentin që kishte shkaktuar vdekjen e të birit të kërkuesit. Faktikisht në hetimin gjatë vitit të parë pas incidentit nuk pati asnjë përparim. Përpjekjet e prokurorit për të identifikuar punonjësit e policisë që kishin hedhur bombat gaz lotsjellës nuk vijuan ose u vijuan vetëm me një vonesë të papranueshme dhe pjesërisht. Për më tepër, zyra e prokurorit ishte vonuar në marrjen në pyetje të kërkuesit, numrit të vogël të policëve identiteti i të cilëve ishte komunikuar dhe të dëshmitarëve okularë. Përveç kësaj, thjesht fakti që nuk ishin ndërmarrë hapat e duhur për të ulur riskun fshehjes përbënte një pengesë të konsiderueshme në përshtatshmërinë e hetimit.

Për më tepër, me gjithë kërkesën e kërkuesit, nuk është vendosur për asnjë raport ekspertize me synim përcaktimin e mënyrës në të cilën është bërë gjuajtja, veçanërisht kur duket se ajo është bërë drejtpërdrejt dhe në një vijë të drejtë, dhe jo me kënd, dhe nuk mund të konsiderohej si një veprim i përshtatshëm nga ana e policisë. Në momentin përkatës, ligji turk nuk kishte ndonjë dispozitë specifike që të rregullonte përdorimi e armëve jo-vdekjeprurëse, si bombat gaz lotsjellëse, gjatë demonstratave apo ndonjë udhëzim për përdorimin e tyre. Mund të nxirret përfundimi që punonjësit e policisë kanë pasur një autonomi të gjerë veprimi dhe janë lënë me më shumë mundësi për të ndërmarrë veprime të pandershme nga çdo të kishin nëse ata

do kishin pasur përfitimin e trajnimit dhe udhëzimeve të duhura. Një situatë e tillë nuk ofronte nivelin e mbrojtjes ‘bazuar në lidhje’ për të drejtën e jetës që kërkohet në shoqëritë moderne demokratike në Evropë. Më pas nuk pati hetime të përshtatshme në nivel vendor që të ishte në gjendje të rindëronte rrethanat që kishin shkaktuar vdekjen e të birit të kërkuesit dhe Qeveria nuk kishte treguar në mënyrë bindëse që përdorimi i forcës vdekjeprurëse ndaj të birit të kërkuesit ishte absolutisht e nevojshme dhe proporcionale. E njëjta zbatohet për fazat e planifikimit dhe kontrollit të operacionit; Qeveria nuk ishte dhënë ndonjë provë për të sugjeruar që policia kishte treguar kujdesin e duhur për të garantuar që ishte minimizuar çdo rrezik për jetën. Për më tepër, në lidhje me detyrimin e tyre pozitiv sipas fjalisë së parë të Neni 2 par 1 për të marrë masa legjislative dhe administrative të përshtatshme, autoritetet turke nuk kishin bërë gjithçka që mund të pritej prej tyre në mënyrë të arsyeshme, për t’u ofruar qytetarëve, dhe veçanërisht atyre ndaj të cilëve ishte përdorur forca potencialisht vdekjeprurëse, nivelin e përshtatshëm të garancive dhe për të mënjanuar riskun e vërtetë dhe imediat për jetën që mund të shkaktonin operacionet e policisë për të shtypur demonstrimet e dhunshme. Duke pasur parasysh konsideratat e mësipërme, nuk është vërtetuar që përdorimi i forcës të cilës iu nënshtroa i biri i kërkuesit nuk kishte shkuar tej asaj është absolutisht e nevojshme. Përveç kësaj hetimi nuk ishte i efektshëm.

Neni 46

- (a) *Masa të përgjithshme* – në lidhje me masat e përgjithshme që Shteti duhej të merrte në ekzekutimin e këtij vendimi, shkelja e së drejtës së jetës për të birit e kërkuesit, të garantuar nga Neni 2 i Konventës, kishte rezultuar përsëri nga mungesa e garancive që do të siguronin përdorimin korrekt të bombave gaz lotsjellës. Për pasojë, Gjykata theksoi nevojën e fuqizimit të garancive pa vonesë të mëtejshme, me qëllim që të minimizohen rreziqet për vdekjen dhe dëmtimit që shoqërojnë përdorimin e bombave gaz lotsjellës. Në këtë aspekt, për sa kohë sistemi turk nuk respekton kërkesat e Konventës, përdorimi i papërshtatshëm i këtyre armëve potencialisht vdekjeprurëse gjatë demonstratave mund të shkaktoje shkelje të ngjashme me ato që u konstatuan në këtë rast.
- (b) *Masa individuale* – Në lidhje me masat individuale, duke ditur që dosja hetimore ishte e hapur në nivel kombëtar dhe nën dritën e dokumenteve në zotërim të saj, Gjykata konsideroi që masat e reja hetimore duhet të

ndërmerren nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave. Veçanërisht, masat e kërkuara nga autoritetet e brendshme me qëllim që të dënohet padënueshmëria duhet të përfshinin një hetim penal të efektshëm që të synojë identifikimin dhe, sipas rastit, dënimin e atyre që janë përgjegjës për vdekjen e të birit të kërkuesit.

Neni 41: 65 000 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar; pretendimi për dënim financiar refuzohet.

NENI 3

Trajtimi çnjerëzor dhe poshtëruës

Përdorimi i armëve elektroskok (Tasers) gjatë kontrollit të befasishtëm në zyrat e shoqërisë: *shkelje*

Anzhelo Georgiev dhe të tjerë kundër Bullgarisë - 51284/09

Vendimi 30.9.2014 (Seksioni IV)

Faktet – Punonjës të maskuar të policisë bënë kontroll të befasishtëm në zyrat ku punonin kërkuesit. Gjatë operacionit ata përdorën armët elektroskok në gjendje aktive, me pretendimin për të mënjeluar rezistencën e kërkueseve dhe për të parandaluar shkatërrimin e provave. Disa prej kërkuesve nga kjo pësuan djegie. Një hetim paraprak në akuzat e kërkuesve përfundoi me një vendim të prokurorit ushtarak për të mos filluar procedimin penal ndaj punonjësve përkatës.

Ligji – Neni 3. Armët elektroskok të aplikuara në gjendje aktive (të njohura si gjendje “paralizuuese”) dihet që shkaktojnë dhimbje të madhe dhe paralizim të përkohshëm. Ligji bullgar në atë kohë nuk kishte dispozita specifike për përdorimin e mjeteve elektroskok nga policia, e cila nuk ishte e trajnuar në përdorimin e tyre. Gjykata vuri re që në Raportin e saj të Përgjithshëm të 20-të, Komiteti për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin apo Dënimin Çnjerëzor dhe Poshtëruës (CPT) kishte shprehur rezerva të forta në lidhje me përdorimin e armëve elektroskok në gjendje aktive. Punonjësit e agjencive ligj-zbatuese të trajnuar rregullisht kanë pasur teknika të tjera kontrolli të disponueshme

prej tyre kur ata ishin në afërsi prekjeje me një person i cili duhet të neutralizohet. Duke pasur parasysh mos vërtetimin nga hetimi paraprak të hollësive në lidhje me rrethanat e sakta të incidentit dhe për të raportuar gjerësisht në lidhje me përdorimin e forcës në masën the llojin e pretenduar, Qeveria kishte dështuar në realizimin e hedhjes poshtë të versionit të aplikantëve, në lidhje me ngjarjet ose të jepte argumente bindëse për të justifikuar intensitetin e forcës së përdorur. Kështu ka pasur shkelje të aspekteve procedurale dhe lëndore të nenit 3.

Përfundimi: shkelje (njëzëri).

Neni 41: EUR 2,500 në lidhje me dëmin jo-financiar për çdo kërkues, ankimi i të cilëve u deklarua i pranueshëm.

Hetim i efektshëm

Mos hapje e përsëritur nga komiteti hetimor i çështjes penale për pretendimet e besueshme për keqtrajtimi nga policia: shkelje

Lyapin kundër Rusisë - 46956/09

Vendim 24.7.2014 (Seksioni I)

Faktet – Në prill të vitit 2008 kërkuesi u arrestua në lidhje me një hetim në një seri vjedhjesh. Ai pretendon që ndërsa në ndalimin policor atij i është mbyllur goja, është lidhur me rrip, është goditur me grushte, shkelma dhe i është nënshtruar shokut elektrik për 12 orë. Megjithëse një komitet hetimor kreu një para hetim për dëmtimet e tij, ai vazhdimisht refuzoi të hapte çështje penale, që do t'u kishte dhënë mundësi hetuesve të përdornin gamën e gjerë të masave hetimore të disponueshme. Ankimi i kërkuesit ndaj refuzimit të dhjetë të komitetit në dhjetor 2009, u refuzua nga gjykatat vendase, që ishin të mendimit që hetimi paraprak ishte i hollësishëm dhe vendimi i ligjshëm dhe i arsyetuar.

Ligji – Neni 53

- (a) *Aspekti lëndor* – Kërkuesi iu ishte nënshtruar disa veprimeve të dhunës fizike dhe kjo i kishte shkaktuar atij vuajtje fizike dhe mendore. Nënshtrimi ndaj shokut elektrik dhe lidhja në një pozicion të dhimbshëm do të kishte kërkuar një përgatitje të caktuar dhe njohuri nga ana e punonjësve të policisë, të cilët me qëllim e aplikuan këtë trajtim për të marrë një deklaram. Një trajtim i tillë barazohej me dhunën.

Përfundim: dhunë (njëzëri)

- (b) *Aspekte procedurale* – Hetimi paraprak shërbeu si fazë fillestare në trajtimin e ankimit penal sipas ligjit rus në procedurën penale. Hetimi duhej të zhvillohej shpejt dhe, nëse zbuloheshin elementë të një veprë penale, do të pasohej nga hapja e çështjes penale dhe hetimit penal. Në rastin e kërkuesit, për shkak të refuzimit të vazhdueshëm për një periudhë më shumë se 20 muaj për hapjen e çështjes penale, me gjithë provat e besueshme mjekësore në mbështetje të pretendimeve të kërkuesit për keqtrajtim, komiteti hetimor nuk zhvilloi në “hetim paraprak” në ankesën e kërkuesit; d.m.th., një hetim penal të plotë, në të cilin të zbatoheshin të gjitha masat hetimore. Si rezultat, punonjësit e policisë të cilët mund të hidhnin dritë mbi ngjarjet nuk u morën asnjëherë në pyetje si dëshmitarë duke iu nënshtruar përgjegjësisë penale për pengim të drejtësisë ose për refuzim dëshmie dhe nuk është bërë e mundur të zhvillohej një ballafaqim më një paradë identifikimi.

“Hetimi paraprak” si i tillë nuk ishte në gjendje të vërtetonte faktet për të realizuar dënimin e personave përgjegjës, meqenëse hapja e çështjes penale dhe e hetimit penal janë parakushte për ngritjen e akuzës që, më vonë, do të shqyrtohej nga gjykata. Duke u përballur me çështje të panumërta të këtij lloji kundër Rosisë, Gjykata ishte e detyruar të nxirrte përfundime më të forta nga fakti i refuzimit të autoritetit hetimor për të hapur hetimin penal në lidhje me pretendimet e besueshme të trajtimit të rëndë gjatë ndalimit policor. Mospërmbushja e detyrës nga komiteti hetimor për të kryer një hetim të efektshëm nuk është korrigjuar nga gjykatat vendase, të cilat kishin rishikuar vendimet e tij. Në paketën e parë të procedimeve, ato kishin refuzuar të kryenin një rishikim gjyqësor për shkas se ndaj kërkuesit po zhvillohej procedimi penal. Në një paketë tjetër procedimesh, vendimi i tyre nuk ishte ekzekutuar nga komiteti hetimor, që do të thotë që defekti i identifikuar nga gjykatat kishte vazhduar të shfaqej në shtatë vendimet pasuese të komitetit gjatë gjithë vitit në vazhdim. Së fundmi, gjykata vendase, pa ushtruar ndonjë

hetim të pavarur, la në fuqi vendimin e komitetit hetimor për të mos hapur një çështje penale. Kështu, ka pasur shkelje të Nenit 3 në aspektet e tij procedurale.

Përfundim: shkelje (njëzëri)

Neni 41: 45,000 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar

NENI 5

Neni 5 § 3

Kohëzgjatja e ndalimit hetimor

Afati prej mbi pesë vjet në ndalim hetimor për shkak të vështirësive në marrjen e provave nga jashtë shtetit: *nuk ka shkelje*

Ereren kundër Gjermanisë - 67522/09

Vendimi 6.11.2014 (Seksioni V)

Faktet – Kërkuesi u arrestua në Gjermani në prill të vitit 2007 në zotërim të dokumenteve të identitetit të falsifikuara. Ai qëndroi i ndaluar dhe, pas hetimeve të mëtejshme, ai u ndalua në lidhje me vepra penale të dyshuara për terrorizëm të kryera në Turqi. Ndalimi i tij u shty në mënyrë të përsëritur për shkak se ka pasur rrezik të pengimit dhe arratisjes, pasi ai nuk kishte vendbanim të qëndrueshëm në Gjermani. Në shtator të vitit 2011, një gjykatë apeli e dënoi atë për dy pika të vrasjes me dashke dhe e dënoi atë me burgim të përjetshëm, por dënimi i tij u shfuqizua dhe çështja u dërgua për rigjykim në të njëjtën gjykatë me trup tjetër gjykues. Gjykimi nuk kishte përfunduar në datën e vendimit të Gjykatës Evropiane. Në total, kërkuesi ka kaluar pesë vjet dhe tetë muaj në ndalim në dy afate të veçantë para lirimit me urdhër të gjykatës së apelit në shkurt 2014, për shkak se, megjithëse procedimi penal nuk ka përfunduar, ndalimi i tij i mëtejshëm do të ishte jo-proporcional. Në kërkesën e tij në Gjykatën Evropiane, e kërkuesi u ankua për gjatësinë e ndalimit të tij hetimor.

Ligji – Neni 5 par 3: Gjykata pranoi që ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm që kërkuesi ka kryer vepra të rënda penale dhe mund të arratisë përbënin shkaqe me rëndësi dhe të mjaftueshme për ndalimin e tij në vazhdimësi. Megjithatë, ajo duhej gjithashtu të pohonte që autoritet gjyqësore kishin demonstruar “kujdes të veçantë” në zhvillimin e procedimit. Ishte shkak i pranueshëm që vonesat ishin shkaktuar kryesisht nga vështirësitë e marrjes së provave nëpërmjet letër porosive nga Turqia. Në këtë kuptim, Gjykata vuri re që ndërsa disa vonesa në procedurën penale brenda kuadrit të ligjeve ndërkombëtare antiterrorizëm janë të paevitueshme për shkak të vështirësive të marrjes së provave në vende të ndryshme, një qëndrim pro-aktiv ishte megjithatë i nevojshëm për të përshpejtuar procedurën sa më shumë të jetë e mundur. Në rastin e kërkuesit, gjykata e apelit kishte udhëtuar katër herë në Turqi për të ndjekur kërkesat me anë të letër porosive dhe kështu nuk mund të thuhej që ata nuk kanë ushtruar kujdes të veçantë. Për më tepër, kërkuesi ishte bërë shkak për zgjatjen e procedimit nëpërmjet kërkesës drejtuar gjykatës së apelit për rihapjen e marrjes së provave. Ndërsa ai ka pasur të drejtë të ushtrojë të drejtat e tij procedurale, çdo zgjatje e procedimit për pasojë nuk mund ti ngarkohet Shtetit. Ndalimi i zgjatur i kërkuesit i është nënshtruar rishikimit të vazhdueshëm në të cilat janë shqyrtuar me kujdes shkaqet e ndalimit në dritën e të gjithë provave të disponueshme. Vërtet që gjykata e apelit ka vendosur në shkurt 2014 të lirojë kërkuesin për shkak se ajo nuk ishte në gjendje të përshpejtonte procedimin në mënyrën që ishte e nevojshme duke pasur parasysh kohëzgjatjen e përgjithshme të ndalimit të kërkuesit. Ajo i ishte referuar shprehimisht parimit të proporcionalitetit. Kjo kërkesë pra duhet të dallohet nga rastet e tjera ku Gjykata ka konstatuar që kohëzgjatja e ndalimit hetimor nuk ka qenë justifikuar nga kompleksiteti i procedimit ose që gjykatat vendase nuk kishin zhvilluar procedimin me kujdesinë e veçantë ose në të cilin kërkuesit nuk janë liruar para përfundimit të procedimit penal. Në dritën e këtyre faktorëve dhe, veçanërisht, të shqyrtimit të hollësishëm të shkaqeve për ndalimin nga gjykatat vendase, kohëzgjatja e ndalimi të kërkuesit, megjithëse e konsiderueshme, përsëri mund të konsiderohet e arsyeshme.

Përfundim: nuk ka shkelje (njëzëri).

NENI 6
Neni 6 par 1 (Ekzekutimi)
Afati i arsyeshëm

Mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë nga Shteti në një afat të arsyeshëm: *shkelje*

Liseytseva dhe Maslov kundër Rusisë - 39483/05 dhe 40527/10

Vendimi 9.10.2014 (Seksioni I)

Faktet – Të dy kërkuessit punonin për shoqëri në pronësi të bashkisë që operonin sipas një regjimi të specifikuar ligjor që u jepte atyre ‘të drejtën e kontrollit ekonomik’. Shoqëritë që punonin sipas këtij regjimi nuk i kishin në pronësi faktorët e punës dhe mund të zhvillonin aktivitetin e tyre vetën në masën që ata nuk dilnin tej qëllimeve dhe objektivave statutores. Ata nuk ishin përgjegjës për borxhet e pronarëve të tyre dhe pronarët normalisht nuk ishin përgjegjës për borxhet e shoqërive. Kërkuessit nisën çështjen ndaj shoqërive për pagat e prapambetura dhe gjykatat vendase vendosën në favor të tyre. Megjithatë, në momentin që vendimet e gjykatës morën formë të prerë, shoqëritë kishin falimentuar. Kërkuessit filluan çështje ndaj bashkive që kishin në pronësi shoqëritë por këto u refuzuan pasi bashkitë u konsideruan që nuk ishin përgjegjëse për falimentimin. Në momentin e vendimit të Gjykatës Evropiane, vendimet në favor të kërkuessve ishin të pa ekzekutuara.

Ligji – Neni 6 i Konventës dhe Neni 1 i Protokollit nr 1.

(a) Pranueshmëria (përputhshmëria “*ratione personae*” dhe përgjegjësia e Shtetit të paditur për borxhet e shoqërive) – Ndërmarrjet e kontrolluara nga shteti gëzonin një lloj pavarësie ligjore dhe ekonomike. Megjithatë, ato kishin tipare që i dallonin ato nga shoqëritë private ‘klasike’, pasi sipas ligjit të brendshëm Shteti mund të kontrollonte aspektet thelbësore të aktivitetit të këtyre shoqërive dhe objekti i kontrollit të Shtetit mund të forcohej më tej duke pasur parasysh funksionet e veçanta që kryheshin.

Kështu kuadri ligjor ekzistues nuk u jepte këtyre shoqërive ata shkallë të pavarësisë institucionale dhe operative që do të lironte Shtetin e paditur nga përgjegjësia për borxhet e këtyre shoqërive.

Në rastin e kërkesit të parë, shoqëria debitorë kishte ofruar shërbimet e transportit publik për disa grupe individësh falas, me kusht që shpenzimi i këtyre shërbimeve të ri mbursohej nga fondet publike më vonë. Megjithatë, autoritetet publike nuk e respektuan detyrimin e tyre në kohën e duhur, kështu shkaktoi vështirësinë financiare të shoqërisë. Për më tepër, bashki kishte disponuar mbi pronën e shoqërisë sipas bindes së saj. Pra, dukej sikur në këtë kohë prona dhe aktivitetet e shoqërisë kontrolloheshin dhe menaxhoheshin nga Shteti në një masë të konsiderueshme ndërsa shoqëria nuk kishte pavarësinë e mjaftueshme institucionale dhe operative. Për pasojë, autoriteti i bashkisë, dhe në këtë mënyrë Shteti, sipas Konventës duhej të konsiderohej përgjegjës për borxhin e vendimit në favor të kërkesit të parë.

Në lidhje me çështjen e kërkesit të dytë, lidhjet institucionale me administrimin publik ishin fuqizuar nga natyra e veçantë e aktiviteteve të tij, pasi ai ofronte shërbimet e furnizimit me ujë dhe ngrohjeje të cilat, sipas natyrës së tyre, ishin të një rëndësie të madhe për popullatën lokale. Prona e caktuar për këto qëllime për pasojë kishte një trajtim të veçantë sipas ligjit të brendshëm. Për më tepër, tarifat për shërbimet e furnizimit me ujë dhe ngrohjes të ofruara nga shoqëria ishin caktuar nga administrata e rrethit dhe politika e caktimit të tarifave e miratuar nga administrata lokale kishte efekt të konsiderueshëm mbi gjendjen financiare të shoqërisë. Kështu, aktivitetet thelbësore të shoqërisë përbëheshin nga ‘detyrat publike të kryera nën kontrollin e autoriteteve’. Për më tepër, shkalla faktike e kontrollit të Shtetit mbi shoqërinë u demonstrua nga fakti që në vitin 2005 – 2006, administrata lokale, pas disponimit mbi sendet pasure të shoqërisë, vendosi ta mbyllë atë, me rezultatin që ajo nuk ishte në gjendje të përmbushte pretendimet e kërkesit në procedurën e falimentimit. Këto rrethana tregonin qartësisht që mbi shoqërinë debitorë ishte ushtruar një shkallë e lartë e kontrollit nga autoriteti bashkiak, që nuk gëzonte nivelin e pavarësisë institucionale dhe operative të nevojshme për të përjashtuar përgjegjësinë e autoritetit bashkiak, pra të Shtetit, për të paguar borxhet në favor të kërkesit të dytë.

Përfundim: kundërshtimi paraprak refuzohet (njëzëri)

(b) Themeli

Neni 6: Duke pasur parasysh konstatimin e përgjegjësisë së Shtetit për borxhet ndaj kërkesve në këtë çështje, afati i mosekzekutimit duhet të përfshijë afatin e rikuperimit të borxhit në kuadrin e procedurës së

falimentimit. Vendimi në favorin e kërkuarit të dytë ka mbetur i pa ekzekutuar për afërsisht më shumë se një vit dhe tetë muaj nga data e likuidimit të shoqërisë debitorë. Tre vendime në favor të kërkuarit të parë kanë mbetur pjesërisht të pa ekzekutuara për periudha që janë ndërmjet dy vjet e gjysmë dhe më shumë se tre vjet para se shoqëria kishte pushuar së ekzistuari. Ndërsa procedura e likuidimit objektivisht mund të justifikonin disa vonesa të kufizuara në ekzekutim, mos-ekzekutimi në vazhdimësi i vendimeve në favor të kërkuarit për disa vjet nuk mund të justifikohet në asnjë rrethanë. Kështu, duke mos marrë për disa vjet masat e nevojshme për të përmbushur vendimet përfundimtare në këtë çështje, autoritetet vendase u kanë hequr të gjithë efektin e dobishëm dispozitave të Nenit 6, par 1.

Përfundimi: shkelje (njëzëri)

Neni 1 i Protokollit nr 1: Duke mos marrë masat e nevojshme për një periudhë të konsiderueshme për të respektuar vendimin përfundimtar, autoritetet vendase kanë penguar kërkuarit në marrjen e shpërblimit të plotë për të cilin ata kishin të drejtë. Kjo ka rezultuar në ndërhyrje jo-proporcionale në gëzimin normal të sendeve të tyre.

Përfundimi: shkelje (njëzëri)

Gjykata ka konstatuar gjithashtu edhe një shkelje të nenit 13 të Konventës.

Neni 41: 3000 Euro për kërkuarin e parë dhe 1 500 Euro për kërkuarin e dytë në lidhje me dëmin jo-financiar; 338 Euro për kërkuarin e parë dhe 2 020 Euro për kërkuarin e dytë në lidhje me dëmin financiar.

Neni 6 § 3 (d)

Marrja në pyetje e dëshmitarëve

Dënimi i bazuar në deklaratimet e dëshmitarëve jo të pranishëm: *nuk ka shkelje*

Horncastle dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar - 4184/10

Vendimi 16.12.2014 Seksioni IV

Faktet – Në nëntor 2007, kërkuesi i dytë dhe i parë Z Horncastle dhe Z Blackmore, u dënuan për plagosje të rëndë trupore me dashje me vendim unanim jurie. Viktima e tyre ka dhënë një deklaram me shkrim për policinë duke identifikuar sulmuesit por kishte vdekur para gjyqit nga një sëmundje tjetër. Deklarimi u pranua si provë ndaj të dy kërkuesve. Në maj të vitit 2008, kërkuesi i tretë dhe i katërt, Z Marquin dhe Z Graham, u dënuan për marrjen peng të një gruaje gjatë një sulmi për vjedhje. Gjatë pengmarrjes ata e kërcënuan ta dëmtonin atë. Viktima dhe bashkëshorti i saj fillimisht bënë deklarime me shkrim në polici por më vonë refuzuan të paraqiteshin si dëshmitarë në gjyq pasi ata kishin frikë për sigurinë e familjeve të tyre. Deklarimi i viktimës u pranua si provë ndaj të dy burrave por gjyqtari refuzoi të pranonte deklaramin e burrit të saj. Të gjithë ankimet e kërkuesve ndaj dënimit u refuzuan.

Ligji – Neni 6 par 1 në lidhje me Nenin 6 par 3 (d): Gjykata zbatoi parimet e përcaktuara në *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*. Dhoma e Madhe vendosi në atë rast që kur prova e një dëshmitari që nuk është i pranishëm është bazë e vetme ose vendimtare për një dënim, kërkohen faktorë të tjerë të mjaftueshëm që lejojnë vlerësimin e besueshmërisë së provës. Gjykata duhet të vendosë nëse ka arsye të besueshme për mos-praninë e dëshmitarëve; nëse deklaramet e dëshmitarëve kanë qenë ‘të vetmet dhe vendimtare’; dhe nëse është rasti, nëse ka pasur masa të përshtatshme balancuese për të mbrojtur të drejtën e kërkuesit për një gjykim të drejtë.

(a) *Kërkuesi i parë dhe i dytë* – vdekja e viktimës e ka bërë të nevojshme të pranohet deklarami i tij ose provë e dhënë verbalisht. Nëse deklarami ka qenë i vetëm dhe vendimtar, pika e fillimit ishin vendimet e gjykatave vendase. Gjyqtari i çështjes, në përfundim, tha që çështja e ndjekjes penale varej nga prova e viktimës. Gjykata e Apelit identifikoi prova të mjaftueshme të ndryshme nga deklarami i viktimës, por pranoi gjithashtu që deklarami ishte ‘në një masë të konsiderueshme’ baza e dënimeve të kërkuesve. Megjithatë, sipas mendimit të Gjykatës, ishte më shumë se e debatueshme që fuqia e provave të tjera fajësuese në çështje, veçanërisht pranimet e kërkuesit të parë dhe të dytë që ata ishin të pranishëm në apartamentin e viktimës atë natë, do të thoshin që deklarami i viktimës nuk ishte ‘vendimtar’ në kuptimin e të qenit përcaktues për rezultatin e çështjes. Edhe në prezumimin që deklarami i

viktimitës ishte ‘vendimtar’, ka pasur faktorë të mjaftueshëm balancues për të kompensuar çdo vështirësi të shkaktuar nga mbrojtja nga pranimi i saj, duke përfshirë kuadrin legjislativ që rregullon rrethanat në të cilat mund të pranohen provat e dhëna verbalisht dhe mundësinë për kërkuesit të kundërshtojnë pranimin e tyre. Garancitë e parashikuara në ligj kanë zbatuar rregullisht, Kërkuesit kanë qenë në gjendje të paraqisnin prova për të kundërshtuar përgjegjësinë e deklarimit dhe besueshmërinë e viktimitës. Të marra me efektin e provave të tjera të ndjekjes penale në këtë çështje, dispozitat e ligjit të zbatuara në rastin e kërkuesve i kanë dhënë mundësi jurisë të zhvillojë një vlerësim të drejtë e të përshtatshëm të besueshmërisë së deklarimit të viktimitës.

Përfundim: nuk ka shkelje (unanimisht)

(b) | *Kërkuesi i tretë dhe i katërt* – Gjyqtari i çështjes ka bërë hetime të përshtatshme në lidhje me nivelin e frikës së viktimitës për të demonstruar nevojën e pranimit të deklarimit me shkrim. Nëse kjo deklaratë ka qenë e natyrës unike ose vendimtare, Gjykata e konsideroi të rëndësishme që Gjykata e Apelit nuk e konsideroi provën e viktimitës të një mase vendimtare. Në këtë çështje kishte prova të mjaftueshme të pavarura duke përfshirë filmimin CCTV të pranuar, duke e vendosur kërkuesin e tretë jashtë shtëpisë së viktimitës në momentin e rrëmbimit, të dhënat e regjistrimeve telefonike të pranuar që tregojnë thirrjet nga telefoni i viktimitës dhe nga telefoni i kërkuesit të katërt tek partneri i viktimitës në datën e peng-marrjes dhe prova që dy kërkuesit ishin regjistruar në një hotel me automjetin e vjedhur në zotërim të tyre. Ka patur dhe prova të tjera nga dëshmitarët duke përfshirë babin e viktimitës dhe punonjësën e policisë i cili kishte dëgjuar telefonatat kur ishin kërkuar para. Për pasojë, nën dritën e provave të tjera të fuqishme inkriminuese, nuk mund të thuhet që deklarimi i viktimitës ishte në një rëndësie apo mase të atillë që do të diktonte rezultatin e çështjes ndaj kërkuesit të tretë dhe të katërt. Kështu, nuk ishte baza vendimtare dhe e vetme për dënimet e tyre. Në këto rrethana, nuk është e nevojshëm të shqyrtohet nëse ka pagur faktorë të tjerë të mjaftueshëm balancues, që lejojnë një vlerësim të drejtë dhe të përshtatshëm për besueshmërisë së deklarimit).

Përfundimi: Nuk ka shkelje (njëzëri)

Neni 6 § 3 (e) **Ndihmë falas nga përkthyesi**

Mungesa e aksesit tek një përkthyesi gjatë marrjes në pyetje nga policia:
shkelje

Baytar kundër Turqisë - 45440/04

Vendimi 14.10.2014 (Seksioni II)

Faktet – Më 17 dhjetor 2001, kërkuesja vizitoi vëllanë e tij i cili po vuante një dënim me burgim në lidhje me një çështje që përfshinte PKK-në, një organizatë e armatosur dhe e paligjshme. Ajo u arrestua pas kontrollit dhe gjetjes në zotërim të një dokumenti në lidhje me, ndërmjet të tjerash, strategjinë e PKK-së deh aktivitetet e saj brenda burgjeve. Ditën tjetër ajo u mor në pyetje nga dy xhandarë në gjuhën turke. Ajo tha që ajo e kishte gjetur dokumentin rastësisht në dhomën e pritjes dhe e kishte marrë. Protokollin e intervistës tregon që ajo ishte informuar në lidhje me të drejtën e saj për ndihmë juridike por ajo nuk dëshironte të merrte. Gjatë një seance para një gjyqtari në datën 18 dhjetor 2001, në të cilën ajo u asistua nga një përkthyes, ajo tha që deklarimi që kishte dhënë për xhandarët iu referohej ngjarjeve në një procedim tjetër dhe ajo nuk kishte qenë në zotërim të ndonjë dokumenti më 17 dhjetor. Në gjykimin e saj pasues, ajo u asistua nga një avokat dhe një përkthyes. Në dënimin e saj, gjykata u mbështet, ndërmjet të tjerash, mbi deklaratimet kontradiktore që ajo kishte bërë në fazën para gjykimore.

Ligji – Neni 6 par 3(e) në lidhje me Nenin 6 par 1: Kërkuesja pretendoi që gjykimi i saj kishte qenë i padrejtë si rezultat i faktit që ajo nuk kishte përkthyes kur ajo u mor në pyetje nga policia. Pranohej që niveli i gjuhës turke e kërkueses ishte e tillë që bënin të nevojshme shërbimet e një përkthyesi. Për më tepër, megjithëse kërkuesi ishte ndihmuar nga një përkthyes në seancën para gjyqtarit përgjegjës për të vendosur në lidhje me ndalimin hetimor, nuk ishte e njëjta gjë kur ajo u mor në pyetje nga xhandarët kur ajo deklaroi që ajo e kishte gjetur dokumentin në fjalë përtokë në dhomën e pritjes në burg, duke pranuar që ajo ishte gjetur në zotërim të një dokumenti. Duke qenë se nuk kishte mundësi t'ia drejtonte pyetjet përkthyesit dhe të krijonte një ide të qartë për veprat që akuzohej, kërkuesja nuk kishte qenë në gjendje të vlerësonte tërësisht pasojat e heqjes dorë prej saj nga e drejta për

të mos folur dhe për ndihmë juridike dhe, për pasojë për të gjithë gamën e shërbimeve që shoqërojnë specifikisht ndihmën juridike. Pra ishte e ligjshme të ngrihej pyetja nëse zgjedhjet e bëra nga kërkuesja kishin qenë të informuara edhe pa pasur akses tek një përkthyes. Sipas mendimit të Gjykatës, kjo pengesë fillestare kishte ndikuar edhe të drejta të tjera që, ndërsa e dalluar nga ajo në lidhje me të cilën pretendohet shkelja, ishin të lidhura ngushtë me të dhe kishin kompromentuar drejtësinë e gjykimit në tërësi.

Ndërsa ishte e vërtetë që kërkuesja ishte ndihmuar nga një përkthyes në seancën para një gjyqtari në përfundim të ndalimit policor, ky fakt nuk mund të korrigjonte defektin që kishte cenuar gjykimin në fazat fillestare. Përveç kësaj, duket se gjyqtari nuk kishte kërkuar për të verifikuar aftësitë e përkthyesit, i cili ishte thjesht një anëtar i familjes së kërkueses i cili ndodhi të ishte i pranishëm në korridor. Për më tepër, megjithëse gjyqtarët e çështjes e kishin bazuar besimin e tyre në një gamë provash, mbeti e pandryshuar që deklaratimet e marra pa asistencën e një përkthyesi ndërsa ajo ishte në ndalim policor kishin shërbyer edhe si basë për dënimin e saj.

Përfundim: shkelje (njëzëri)

Neni 41: 1 500 Euro në lidhje me dëmin jo-pasuror

NENI 8

Mosdhënia e mundësisë babait të pretenduar të fëmijës për të dhënë prova personalisht: shkelje

Tsvetelin Petkov kundër Bullgarisë - 2641/06

Vendim 15.7.2014 (Seksioni)

Faktet – Në mars të vitit 2002 ish-bashkëshortja e kërkuesit ngriti një pretendim në emër të fëmijës së saj për të vërtetuar që ai ishte babai i fëmijës. Meqenëse kërkuesi nuk i paraqiti në gjykatë, avokati u caktua kryesisht për ta përfaqësuar atë. Në një vendim të datës 16 dhjetor 2002, Gjykata e Qytetit e deklaroi kërkuesin si babai biologjik të fëmijës. Kërkuesi mori dijeni për vendimin në prill 2004, por kërkesa e tij për rihapjen e gjykimit

u refuzua për shkak se procedura e saktë për thirrjen e tij ishte respektuar dhe një përfaqësues ligjor ishte caktuar ta përfaqësonte atë.

Ligji – Neni 8: Autoritetet vendase ishin përballur me një konflikt ndërmjet interesave konkurruese të fëmijës lindur jashtë martesë, nënës së fëmijës dhe kërkuesit si babai i mundshëm. Çështje thelbësore ishte nëse pjesëmarrja personale e kërkuesit në gjykim kishte qenë e domosdoshme për të ushtruar efektivisht të drejtën e jetës private. Rezultati i gjykimit për vërtetimin e anësisë së kërkuesit kishte pasojë të drejtpërdrejta dhe të konsiderueshme për jetën e tij private. Ishte e vërtetë që vendimi i autoriteteve për të vazhduar me seancën për këtë çështje, dhe jo ta shtynin atë derisa të gjendej kërkuesi, mbase ka ndjekur një qëllim legjitim për zhvillimin e gjykimin me shpejtësinë e nevojshme. Megjithatë, detyrimet e tyre pozitive sipas nenit 8 u kërkonin atyre të vendosnin një balancë ndërmjet interesave dhe të drejtave të të gjithë palëve. Autoritetet e kishin ftuar kërkuesin nëpërmjet një publikimi në Gazetën Shtetërore pas zbulimit që ai nuk vazhdonte të banonte në adresën e tij të përhershme. Megjithatë, nuk kishte prova që ata kishin bërë kërkime tek zyra e regjistrimit të adresave apo ishin përpjekur me mjete të tjera të gjenin nëse ai kishte adresë. Në fakt, ata e kishin gjetur atë më në fund në adresën e përhershme në prill të vitit 2004. Kërkuesi ishte deklaruar babai i fëmijës në mungesë të një testi ADN-je. Në këtë kontekst, Gjykata nuk heq dorë nga fakti që testi i ADN-së në atë kohë ishte metoda shkencore e disponueshme për të përcaktuar saktësisht atësinë e fëmijës dhe vlera e saj provuese do të kishte rrëzuar tërësisht çdo provë tjetër të paraqitur nga palët për të provuar ose rrëzuar atësinë biologjike. Garantimi i respektimit efektiv për të drejtën e kërkuesit për jetën private do të thoshte që atij t'i jepej një mundësi të paraqiste çështjen, duke përfshirë dhënien e provave të ADN-së. Duke ditur objektin e mosmarrëveshjes, pjesëmarrja e tij personalisht në gjykim ishte thelbësore për besueshmërinë e rezultatit dhe përfaqësimi i tij nga avokati i caktuar kryesisht nuk ishte e mjaftueshme të garantohej prezantimi efektiv, i saktë dhe i pranueshëm i çështjes së tij. Për pasojë, autoritetet nuk kishin gjetur balancën e duhur ndërmjet të dhjetës së kërkuesit për jetën private dhe të drejtës së fëmijës për t'iu vërtetuar atësia dhe të nënës për marrjen e detyrimit ushqimor për fëmijën.

Përfundim: shkelje (njëzëri)

Neni 41: 4 500 Euro, në lidhje me dëmin jo-financiar; pretendimi në lidhje me dëmin financiar rrëzohet.

Respektimi i jetës private dhe familjare; Detyrime pozitive

Refuzimi për t'i dhënë kërkueses numër identiteti pas ndryshimit të seksit, nëse martesë nuk transformohej në partneritet civil: nuk ka shkelje

Hðmðlðinen kundër Finlandës - 37359/09

Vendimi 16.7.2014 (GC)

Faktet – Sipas ligjit finlandez, martesë lejohet vetëm ndërmjet personave me sekte të kundërta. Megjithatë, ndërsa çiftet e të njëjtit seks nuk lejohet të martohen, ata mund të hyjnë në partneritete civile. Kërkuesi lindi si mashkull dhe u martua me një grua në vitin 1996. Çifti lindi një fëmijë në vitin 2002. Në vitin 2009 kërkuësja bëri një operacion për ndryshim gjinie. Megjithatë, megjithëse ajo ndryshoi emrin e saj të parë ajo nuk mund të ndryshonte numrin e identitetit të saj në një femër, përveç nëse bashkëshortja e saj do të jepte pëlqimin për transformimin e martesës së tyre në një partneritet civil ose çift i divorcuar. Kërkuësja dhe bashkëshortja e saj dëshironin të mbeteshin të martuara pasi divorci do të ishte kundër besimeve të tyre fetare dhe ato ishin të mendimit që një partneritet civil nuk ofronte të njëjtën garanci si martesë për ata dhe fëmijën e tyre. Në kërkesën e saj në Gjykatën Evropiane, kërkuësja u ankua, ndër të tjera, sipas Nenit 8 të Konventës që e drejta e saj për jetë private dhe familjare ishte shkelur kur njohja e plotë e gjinisë së saj të re kushtëzohej me transformimin e martesës në një partneritet civil. Në një vendim të datës 13 dhjetor 2012, një Dhomë e Gjykatës vendosi njëzëri që nuk ka pasur shkelje të Nenit 8 të Konventës dhe as shkelje të Nenit 14 në lidhje me Nenin 8.

Ligji – Neni 8: Çështja që duhet të vendoset nga Gjykata ishte nëse respektimi i jetës private dhe jetës familjare të kërkueses përbënte një detyrim pozitiv të Shtetit për të parashikuar një procedurë efektive dhe të aksesueshme që t'i japë mundësi kërkueses që ti njihet gjini e saj e re ligjërisht duke mbetur e martuar. Gjykata përsëriti që Konventa nuk vendos ndonjë detyrim mbi Shtetet Kontraktuese për të lejuar martesën me seks të njëjtën. Rregullimi i efekteve të ndryshimit të gjinisë në kontekstin e martesës përfshihej në një masë të konsiderueshme, megjithëse jo tërësisht, brenda marzhit të vlerësimit të Shteteve Kontraktuese. Për më tepër, Konventa nuk kërkon

ndonjë masë tjetër të veçantë për t'u aplikuar në situatat si ajo e kërkueses. Dhoma e Madhe vuri re që nuk ka akoma konsensus në Evropë për të lejuar martesat e të njëjtit seks dhe nuk ka konsensus në ato Shtete që nuk lejojnë martesat e të njëjtit seks mbi mënyrën e trajtimit të njohjes së gjinisë në rastin e martesës ekzistuese (situata në rastin e kërkueses). Vërtet, shumica e Shteteve nuk kanë në fuqi legjislacion për njohjen e gjinisë. Në mungesë të një konsensusi dhe duke ditur moralin sensitiv dhe çështjet etike që preken, Finlandës duhet t'i jepet një gamë e gjerë vlerësimi, si në vendimin e saj ashtu edhe nëse duhet të miratojë ligje në lidhje me njohjen ligjore të gjinisë së re të trans-seksualëve post-operativë dhe, pas ndërhyrjes, për rregullat e përcaktuara për të arritur një balancë ndërmjet interesave konkurrues publikë dhe privatë. Ligji finlandez i jepte kërkueses tre opsione. Duke lënë mënjanë opsionet e ruajtjes së *status quo*-së ose të divorcit, ankesa e kërkueses drejtohej kryesisht ndaj mundësisë së konvertimit të martesës në një partneritet civil, me pëlqimin e bashkëshortes së saj. Sipas Qeverisë, qëllimi i legjislacionit përkatës ishte të unifikoheshin praktikat e ndryshme që zbatoheshin në pjesë të ndryshme të vendit dhe të vendoseshin kërkesa koherente për njohjen ligjore të gjinisë. Nëse merrej pëlqimi i bashkëshortes, ai parashikonte njohjen ligjore të gjinisë së re dhe mbrojtjen ligjore të marrëdhënies. Gjykata konstatoi që meqenëse konvertimi i martesës në një partneritet civil ishte automatike sipas sistemit finlandez, pëlqimi i bashkëshortes për regjistrimin e ndryshimit të gjinisë ishte një kërkesë elementare e përcaktuar për të mbrojtur secilin bashkëshort nga efekti i vendimeve të njëanshme të marra nga tjetri. Për më tepër, kërkuesja dhe bashkëshortja e saj nuk do të humbnin asnjë të drejtë nëse martesa konvertohen në partneritet të regjistruar. Kështu, për shembull, për qëllimin e vlerësimit të të drejtave të pensionit, kohëzgjatja e marrëdhënies do të llogaritej që nga data e martesës, dhe jo nga data e konvertimit në partneritet civil.

Duke iu kthyer aspekteve familjare të çështjes, Gjykata vuri re që partneriteti civil nuk do të ndikonte atësinë e së bijës së kërkueses, pasi ajo ishte vërtetuar në mënyrë të vlefshme gjatë martesës. Ndërsa ri-caktimi i gjinisë nuk kishte asnjë efekt ligjor mbi përgjegjësinë për kujdesin, kujdestarinë ose detyrimin ushqimor ndaj fëmijës, pasi përgjegjësia prindërore në Finlandë bazohen në të qenit prind, pavarësisht seksit ose formës së partneritetit.

Për pasojë, ndryshimi në një partnerit civil nuk do të kishte ndonjë implikim për jetën familjare të familjes së kërkueses. Ndërsa ishte për të ardhur keq në lidhje me shqetësimet e përditshme për shkak të numrit të saj të pasaktë të identitetit, kërkuësja kishte një mundësi të vërtetë për ta ndryshuar këtë gjendje nëpërmjet konvertimit, në çdo kohë, të martesës së saj ën një partneritet të regjistruar me pëlqimin e bashkëshortes së saj. Sipas mendimit të Gjykatës, nuk ishte dis -proporcionale që kërkohej një konvertim i tillë, si parakusht për njohjen ligjore të një gjinie të përftuar, pasi ky ishte një opsion i vërtetë që ofronte mbrojtje ligjore për çiftet e të njëjtit seks që ishte pothuaj identik me martesën.

Diferencat e vogla ndërmjet këtyre dy koncepteve ligjore nuk ishin në gjendje ta konsideronin të papërshtatshëm sistemin finlandez nga këndvështrimi i detyrimit pozitiv të Shtetit. Sistemi si i tërë nuk ishte dis - proporcional në efektet e tij mbi kërkuesen dhe ishte vendosur një balancë e drejtë ndërmjet interesave konkurruese në çështje.

Përfundim: nuk ka shkelje (katërbëdhjetë vota me tre)

Dhoma e Madhe konstatoi, me katërbëdhjetë vota me tre, që nuk ka pasur shkelje të Nenit 14 marrë në lidhje me Nenin 8 dhe, njëzëri, që nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej ankesa e kërkueses sipas Nenit 12 pasi ishte shqyrtuar sipas Nenit 8.

Respektimi i jetës private dhe familjare **Respektimi i banesës**

Ndërtimi dhe përdorimi i paligjshëm i një varreze pranë banesës dhe furnizimit me ujë të kërkuetit: *shkelje*

Dzemyuk kundër Ukrainës - 42488/02

Vendim 4.9.2014 (Seksioni V)

Faktet – Kërkuesi banonte në një fshat pa furnizim qendror me ujë dhe përdortë ujin nga pusët të ushqyer nga ujërat nëntokësorë për nevojat e ekonomisë së tij shtëpiake. Në vitin 2000 autoriteti lokal vendosi të ndërtonte

një varrezë në një parcelë toke fqinje, afërsisht 40 metra nga shtëpia e tij. Kërkuesi hapi çështjen për anulimin e këtij vendimi dhe mbylljen e varrezës. Përfundimisht, në vitin 2003, gjykata që shqyrtonte kërkesën e pranoi ankimin e tij pas konstatimit që varreza ishte ndërtuar tepër pranë një zone banimi dhe një burimi uji, në shkëlqje të ligjeve dhe rregulloreve mjedisore. Gjykata urdhëroi mbylljen e varrezës, por urdhri nuk u zbatua. Ndërkohë, një analizë bakteriologjike e ujit nga pusi i kërkuesit në vitin 2008 tregoi që indeksi i E. coli bacteria e kalonte shumë nivelin e lejuar nga ligji.

Ligji – Neni 8

- (a) Zbatueshmëria – Gjykata përsëriti që me qëllim që të ngrihet një çështje sipas nenit 8, ndërhyrja e pretenduar duhet të cenohet drejtpërdrejt banesën, familjen ose jetën private të kërkuesit dhe të mbajë një nivel të caktuar minimal. Niveli i lartë i baktereve të gjetura në ujin e pusit të kërkuesit, bashkuar kjo me shkëlqjen flagrante të rregulloreve të brendshme për shëndetin dhe sigurinë e mjedisit konfirmuan ekzistencën e rreziqeve mjedisore, që janë ndotja e rëndë e ujit, që prekte “cilësinë e jetës” të kërkuesit dhe arrinin një shkallë të mjaftueshme të rëndësisë për t’u bërë shkak për zbatimin e Nenit 8.
- (b) Përputhshmëria – Paligjshmëria e vendndodhjes së varrezës ishte sinjalizuar në një numër rastesh nga autoritetet mjedisore dhe shëndetësore dhe ishte njohur nga vendimet e gjykatave të brendshme. Për më tepër, autoritetet kompetente lokale nuk kishin mundur të respektonin një vendim të formës së prerë dhe detyrues të gjykatave vendase me qëllim që të mbyllej varreza. Për pasojë, ndërhyrja në të drejtën e kërkuesit për respektimin e banesës, jetës private dhe familjare të tij nuk ishte “në pajtim me ligjin”.

Përfundim: shkëlqje (njëzëri)

Neni 41: EUR 6,000 në lidhje me dëmin jo-financiar.

NENI 10

Liria e shprehjes

Axel Springer AG kundër Gjermanisë (nr. 2) - 48311/10

Vendim 10.7.2014 (Seksioni V)

Faktet – Kërkuesi ishte shoqëria me përgjegjësi të kufizuar Axel Springer AG. Ndërmjet aktiviteteve të tjera, ajo ishte edhe botuesi i gazetës me qarkullim masiv *Bild*. Kancelari gjerman Gerhard Schroeder, në pushtet deri në vitin 1998, i kishte humbur zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Më 9 dhjetor 2005 u deklarua që ai ishte emëruar kryetar i bordit mbikëqyrës të një konsorciumi gjermano-Rus (NEGP). Kontrata për ndërtimi e një impianti transporti nga ky konorcium ishte nënshkruar dhjetë ditë para zgjedhjeve të parakohshme. Në botimin e 12 dhjetorit 2005, *Bild* publikoi një artikull në faqe të parë me titull “Sa fiton ai faktikisht nga ky projekt impianti? Shroeder duhet të tregojë pagën e tij ruse”. Ish-Kancelari ngriti padi në një gjykatë lokale për një masë të përkohshme për ndalimin e çdo publikimi tjetër të një pasazhi që përshkruan dyshimet e Z Thiele, zëvendës-president i Partisë Liberal-Demokrate FDP, që ish-Kancelari ishte tërhequr nga funksionet e tij politike për shkak se atij i ishte ofruar një post fitimprurës në konsorcium dhe që vendimi për të thirrur zgjedhjet e parakohshme ishte marrë me këtë qëllim të vetëm, të motivuar nga interesi personal. Gjykata lokale urdhëroi që gazeta të mos publikojë pjesën e debatueshme të artikullit. Vendimi u la në fuqi nga gjykata e apelit dhe ankimi kushtetues nga kërkuesi kundër vendimit të gjykatës së apelit u refuzua.

Ligji – Neni 10: Pasazhi debatueshëm, i cili ngrinte çështjen e nëse ish-kancelari dëshironte të hiqte dorë nga posti për shkak të postit të ri që i ishte ofruar në konsorcium, ishte qartësisht pa interes të konsiderueshëm publik, duke ditur profilin e lartë të Kancelarit dhe objektin e raportit. Për pasojë, liria e shprehjes duhej që në këtë rast të shprehej në një gamë të gjerë.

Gjykatat gjermane e kishin ndaluar pasazhin në fjalë për shkak se ai nuk përmbushte kriteret përkatëse për raportimin e dyshimeve. Në këtë artikull, kërkuesi kishte botuar komentet e bëra qartazi nga Z. Thiele. Çështjet e ngritura prej tij ishin më shumë si prezantim vlerash se sa akuza faktike që mund të provohen.

Çështjet e mbuluara nga masa e përkohshme ishin ngritur në një kontekst politik të një interesi të gjerë dhe nuk pretendonin që ish-Kancelari kishte kryer ndonjë veprë penale dhe që mund të mbështetej në fakte të ndryshme. Për më tepër, kreu i një qeverie kishte mundësi të shumta për të publikuar zgjedhjet e tij ose të saj politike për të informuar publikun për to. Kështu artikulli nuk kërkohej të përmbante elementë në mbështetje të ish-kancelarit, dhe pozita i tij nuk i mundësonte atij të gëzonte ndonjë tolerancë shumë të madhe se ajo që u jepet qytetarëve privatë.

Për më tepër, megjithëse shoqëria kërkuese kishte publikuar pasazhin e debatueshëm në gazetën e saj, vetë çështjet që ishin ngritur nga një politikan dhe anëtar i Parlamentit gjerman. Një gazete nuk mund t'i kërkohej të verifikojë në mënyrë sistematike themelin e çdo komenti të bërë nga një politikan në lidhje me një tjetër nëse komente të tilla bëhen në kontekstin e debatit politik publik. Ish-Kancelari mund të ngrinte padi gjyqësore ndaj personit që kishte bërë këto komente të debatueshme. Për pasojë, duke pasur parasysh mënyrën në të cilën gazeta kishte marrë komentet e Z. Thiele dhe duke marrë parasysh natyrën e fundit të deklarimeve në lidhje me ish-Kancelarin, të bëra tre ditë para publikimit të nenit, dhe gjithashtu natyrën përgjithësisht të përkohshme të ngjarjeve të lajmeve, nuk kishte ndonjë tregues që shoqëria kërkuese nuk kishte të drejtë të publikonte këto komente pa bërë verifikime të tjera paraprake. Po ashtu, nuk mund të përfaqësohet që nuk ishte bërë asnjë përpjekje për të kontaktuar ish-Kancelarin ose që ai nuk kishte pasur asnjë mundësi për të reaguar ndaj këtyre çështjeve. Në lidhje me mënyrën e publikimit, artikulli nuk përmbante shprehje në lidhje me ish-Kancelarin, të cilat, për nga natyra e tyre, mund të përbënin çështje sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës. Gjithashtu edhe në lidhje me ndikimin e publikimit, gazeta *Bild* publikohej në të gjithë vendin dhe kishte një nga shifrat më të larta të qarkullimit në Evropë. Së fundmi, në lidhje me ashpërsinë e dënimit të vendosur, shoqëria kërkuese iu nënshtrua masës së përkohshme sipas së drejtës civile për të mos publikuar më tej vetëm një pasazh nga artikulli. Megjithatë, ky ndalim mund të kishte një efekt pengues në ushtrimin e lirisë së shprehjes nga shoqëria kërkuese. Duke pasur parasysh sa më sipër, shoqëria kërkuese nuk i kishte kaluar kufijtë e lirisë së gazetareske në publikimin e pasazhit të debatueshëm. Nuk është vërtetuar që ekzistonte ndonjë nevojë imediate shoqërore për të vendosur mbrojtjen e reputacionit të ish-Kancelarit mbi të drejtën e shoqërisë kërkuese për lirinë e shprehjes dhe interesit të përgjithshëm për të nxitur këtë liri kur bëhet fjalë për çështje

me interes publik. Për pasojë ndërhyrja në fjalë nuk kishte qenë “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Përfundim: shkelje (njëzëri)

Liria e shprehjes

Gazetari i pushuar për shkak të publikimit të një libri që kritikon punëdhënësin e tij në shkelje të klauzolës së konfidencialitetit: *shkelje*

Matúz kundër Hungarisë - 73571/10

Vendim 21.10.2014 (Seksioni II)

Faktet – Kërkuesi ishte gazetar hungarez i punësuar nga shoqëria e televizionit shtetëror. Në vitin 2004, ai u pushua për shkelje të klauzolës së konfidencialitetit pas publikimit të një libri që pretendonte censurimin nga një drejtor i shoqërisë. Kërkuesi e kundërshtoi pushimin e tij në gjykatat vendase por pa sukses.

Ligji – Neni 10 Pushimi i kërkuesit përbënte një ndërhyrje në ushtrimin e të drejtës së tij të mbrojtur nga Neni 10 pasi vendimi u nxit vetëm nga publikimi i librit të tij, pa hetim të mëtejshëm të aftësive të tij profesionale. Libri në thelb kishte të bënte me një çështje me interes publik dhe asnjë palë e tretë nuk ishte ankuar në lidhje me të. Duke i kushtuar vëmendje rolit të luajtur nga gazetarët në një shoqëri demokratike dhe përgjegjësive të tyre për të kontribuar dhe inkurajuar debatin publik, kufizimet e konfidencialitetit dhe detyrimi i diskrecionit nuk mund të thuhet se zbatohen me të njëjtin efekt, duke ditur që ishte në natyrën e funksioneve të tyre të jepnin informacione dhe ide. Për më tepër në kontekstin e veçantë të çështjes së kërkuesit, detyrimet e tij për besnikëri dhe kufizim duhej të peshoheshin kundrejt karakterit publik të shoqërisë transmetuese ku ai punonte. Në këtë aspekt, autoritetet vendase duhej t’i kushtonin vëmendje të veçantë interesit publik në lidhje me sjelljen e kërkuesit. Për më tepër, ndërsa autenticiteti i dokumenteve të publikuara nga kërkuesi nuk ishin vënë në pikëpyetje, disa nga deklaratimet e tij barazoheshin me prezantime vlerash, e vërtetësia e të

cilave nuk mund të provohej. Megjithëse publikimi i dokumenteve në librin e kërkuesit përbënte një shkelje të konfidencialitetit, lënda e tyre ishte bërë tashme e aksesueshme për publikun, nëpërmjet një publikimi “online” para se të publikohej libri. Në lidhje me motivet e kërkuesit, që është, tërheqja e vëmendjes publike brenda televizionit Shtetëror, mirëbesimi i tij nuk ishte vënë asnjëherë në pikëpyetje gjatë shqyrtimeve vendase. Për më tepër, libri u publikua vetëm pasi kërkuesi ishte përpjekur të ankohej në lidhje me censurimin e pretenduar na punëdhënësi i tij por pa sukses. Përveç kësaj, sanksioni i imponuar – ndërprerja e punësimit me efekt të menjëhershëm – ishte tepër i ashpër. Përfundimisht, gjykatat vendase kishin vendosur kundër kërkuesit vetëm për shkak që publikimi i librit shkelte detyrimet e tij të kontraktuara, pa marrë parasysh argumentin e tij që ai po ushtronte lirinë e tij të shprehjes në interesin publik. Gjykatat vendase në këtë mënyrë nuk kishin mundur të shqyrtonin nëse dhe si objekti i librit të kërkuesit dhe konteksti i publikimit mund të kishte ndikuar në objektin e lejueshëm të kufizimit mbi lirinë e shprehjes. Kështu, ndërhyrja në të drejtat e kërkuesit për lirinë e shprehjes nuk kishte qenë “e nevojshme në një shoqëri demokratike.”

Përfundim: shkelje (njëzëri)

Neni 41: EUR 5,000 në lidhje me dënim financiar dhe jo-financiar.

Liria për dhënien e informacionit

Konstatimi përgjegjësisë së publikuesve të artikujve dhe fotografive që tregojnë ekzistencën e fëmijës së fshehtë të monarkut: *çështja referuar Dhomës së Madhe*

Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés kundër Francës - 40454/07

Vendim 12.6.2014 (Seksioni V)

Kërkuesit janë përkatësisht drejtori i publikimit dhe botuesi i revistës javore Paris-Match. Në vitin 2005, revista publikoi një artikull në të cilin Zonja C bëri deklaramë në lidhje me të birin e saj, duke pretenduar që Albert Grimaldi, Princi sundimtar i Monakos, ishte babai i tij. Ajo dha hollësi se si ishte takuar

me princin, takimet e tyre, marrëdhënien dhe ndjenjat e tyre intime, mënyrën në të cilën princi kishte reaguar ndaj lajmit mbi shtatzëninë e saj dhe qëndrimin e tij për takimin me fëmijën. Princi filloi çështje në lidhje me kërkuesit, duke kërkuar kompensim për shkeljen e jetës private dhe shkeljen e së drejtës së tij për mbrojtjen e imazhit të tij. Gjykatat franceze e pranuan pretendimin e tij dhe i dhanë atij një kompensim prej 50 000 Euro; ato urdhëruan gjithashtu që hollësitë e vendimit të gjykatës të publikoheshin në faqen e parë të revistës, duke zënë një të tretën e hapësirës.

Në një vendim të datës 12 qershor 2014 (shih shënimin informativ 175), një Dhomë e Gjykatës konstatoi me një shumicë votash prej 4 me tre që ka pasur një shkelje të Nenit 10 të Konventës. Ajo konstatoi që vendimi kundër kërkuesve nuk kishte bërë dallimin ndërmjet informacionit që përbënte pjesë të një debati me interes të përgjithshëm dhe atij që raportonte vetëm hollësi për jetën private të Princit. Për pasojë, me gjithë marzhën e vlerësimit që u jepet Shteteve në këtë sferë, nuk ka pasur raport të arsyeshëm të proporcionalitetit ndërmjet kufizimeve të vendosura nga gjykatat vendase mbi të drejtat e kërkuesve për lirinë e shprehjes dhe qëllimit legjitim të ndjekur, që është mbrojtja e reputacionit ose të drejtave të të tjerëve.

Më 13 tetor 2014, çështja iu referuar Dhomës së Madhe me kërkesë të Qeverisë.

Liria e shprehjes

Dënimi i një gazetari për publikimin e materialeve që i nënshtrohen konfidencialitetit të një hetimit të papërfunduar: *çështja referuar Dhomës së Madhe*

A.B. (Bedat) kundër Zvicrës - 56925/08

Vendimi 1.7.2014 (Seksioni II)

Më 15 tetor 2003, kërkuesi, gazetar, publikoi një shkrim në një revistë javore në lidhje me një seri procedimesh penale ndaj një shoferi që ishte ndaluar për shkak se kishte shtypur një grup kalimtarësh, duke vrarë tre dhe dënuar tetë

të tjerë, para se të rrëzohej nga Ura e Lozanës. Shkrimi portretizonte të akuzuarin, paraqiste një përmbledhje të pyetjeve të bëra nga policia dhe gjyqtari hetues dhe përgjigje e të akuzuarit dhe shoqërohej me disa fotografi të letrave që ai i kishte dërguar gjyqtarit hetues. Shkrimi përfshinte një përmbledhje të shkurtër të deklarimeve të gruas të të akuzuarit dhe mjekut që ofroi shërbimin. Gazetari u ndoq penalisht për shkak të publikimit të dokumenteve sekrete. Në qershor 2004, gjyqtari hetues e dënoi atë me një muaj burg me kusht. Gjykata e Paqes e zëvendësoi më vonë këtë dënim me një gjobë prej 4 000 franga zvicerane (afërsisht 2 667 Euro). Ankimet e kërkuarit ndaj dënimit të tij u refuzuan.

Me vendim të datës 1 korrik 2014, një Dhomë e Gjykatës, votat e ndara katër me tre, nxori përfundimin që ka pasur shkelje të nenit 10 pasi dënimi i kërkuarit me gjobë për përdorimin dhe riprodhimin e pjesëve nga dosja hetimore nuk përmbushte një “nevojë sociale imediate”. Megjithëse shkaqet e dënimit kanë qenë “me vend”, ato nuk ishin ‘të mjaftueshme’ për të justifikuar një ndërhyrje në të drejtën e lirisë së shprehjes së kërkuarit.

Më 17 nëntor 2014, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesën e Qeverisë.

NENI 11

Liria e tubimit paqësor

Arrestimi dhe dënimi i aktivistëve politikë për zhvillimin e një marshimi të pretenduar të paautorizuar: *shkelje*

Navalnyy dhe Yashin kundër Rusisë - 76204/11

Vendim 4.12.2014 (Seksioni I)

Faktet: Kërkuarit ishin dy aktivistë politikë dhe udhëheqës të opozitës. Në vitin 2011, ata u arrestuan për mosrespektimin e një urdhri të policisë për të ndaluar një marshim spontan që ata pretendojë të kishin zhvilluar pas pjesëmarrjes në një demonstratë të autorizuar. Ata u mbajtën të ndaluar nga

policia para se të nxirreshin para gjykatës ditën tjetër dhe u dënuan me 15 ditë ndalim administrativ. Ankimet e tyre iu refuzuan.

Ligji – Neni 11: Arresti, ndalimi dhe dënimi i kërkuesve përbënte një ndërhyrje në të drejtën e tyre sipas nenit 11. Ai ndiqte një qëllim legjitim për ruajtjen e rendit publik. Në lidhje me proporcionalitetin, Gjykata vuri re që edhe nëse kërkuesit nuk kishin ndër mend të zhvillonin një marrshim, shfaqja e një grupi të madh protestuesish mund të perceptohej si i tillë, Megjithatë, marshimi kishte zgjatur vetëm 15 minuta, ishte paqësor dhe, duke pasur parasysh numrin e pjesëmarrësve, nuk do të ishte e vështirë për ‘u mbajtur nën kontroll. Policia i kishte parë kërkuesit vetëm sepse marshimi nuk ishte i autorizuar. Gjykatat vendase nuk kishin bërë asnjë përpjekje për të verifikuar masën e rrezikut që përbënin protestuesit ose nëse ishte e nevojshme për t’i ndaluar ata. Kërkuesit pastaj u arrestuan për mosrespektim të urdhrave të policisë, por Gjykata nuk ishte në gjendje të vërtetonte nëse policia kishte lëshuar ndonjë urdhër të tillë para se të realizonte arrestimet. Edhe nëse prezumohet që kërkuesit nuk i ishin bindur urdhrit për përfundimin e marshimit, nuk kishte arsye për t’i arrestuar ata. Për më tepër, dënimi i dhënë nuk reflektonte natyrën relativisht të ulët të veprës së pretenduar. Përfundimisht, autoritetet vendase kishin njohur shprehimisht që kërkuesit ishin dënuar për mbajtjen e një demonstrate paqësore spontane dhe thirrjen e parullave anti-qeveritare. Masat shtrënguese të marra kishin një potencial serioz për të penguar mbështetësit e tjerë opozitarë dhe publikun në gjerë në marrjen pjesë në demonstrata dhe, në përgjithësi, nga pjesëmarrja në debatin e hapur politik. Efekti pengues i këtyre sanksioneve ishte fuqizua më tej nga fakti që ato kishin si objektiv figura të njohura publike, heqja e lirisë së të cilëve kishte tërhequr vëmendje të gjerë të mediave. Kështu, ndërhyrja nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Përfundimi: shkelje (njëzëri).

Gjykata konstatoi gjithashtu, njëzëri, shkeljen e Nenit 6 par 1 në lidhje me procedimet administrative ndaj kërkuesve, të Nenit 5 në lidhje me shoqërimin e panevojshëm në rajonin e policisë, ndalimin e pa dokumentuar dhe të panjohur prej gjashtë orësh në transit dhe mungesën e shkaqeve për ndalimin e tyre, të Nenit 13 në lidhje mungesën e mjeteve efektive të brendshme, dhe të Nenit 3 në lidhje m kushtet në të cilat u mbajtën kërkuesit në rajonin e policisë.

Neni 41: 26 000 Euro për secilin kërkues në lidhje me dënimin jo-pasuror.

NENI 1 I PROTOKOLLIT 1

Kontrolli dhe përdorimi i pronës

Konfiskimi i një shtëpie të financuar nga trafikimi i drogës: *e papranueshme*

Aboufadda kundër Francës - 28457/10

Vendimi 4.11.2014 (Seksioni V)

Faktet – Në vitin 2005, kërkuesit blenë një shtëpi, që ata e paguan nga një depozitë dhe duke marrë një hua bankare. Disa muaj më vonë një hetim gjyqësor nxori në pah një operacion të madhe trafikimi droge nga i biri i kërkuesit. Verifikimet financiare të kryera për pasurinë e tij dhe ato të pasuesve të tij, me qëllim që të vërtetohej nëse ishin kryer veprat penale të mos justifikimit të burimeve dhe të pastrimit të parave. Në vitin 2008, i biri i kërkuesve u dënua, ndërmjet masave të tjera, me shtatë vjet burg dhe kërkuesit me tre vjet burgim, dy prej të cilëve u pezulluan. Në rastin e kërkuesve, gjykata kishte urdhëruar gjithashtu që shtëpia e blerë në vitin 2005 të konfiskohej. Gjykata vuri re veçanërisht që i biri i kërkuesve ishte përgjegjës për menaxhimin e punës së kryhej në shtëpi dhe po kontribuonte për shpenzimet, që ai po bënte pagesat e hipotekës dhe përgjimi i telefonit të kërkuesve tregoi që ata ishin në dijeni të aktiviteteve ilegale të të birit të tyre. Kërkuesit ishin të autorizuar të mbeteshin në shtëpi deri në maj të vitit 2011, në këmbim të një qiraje mujore prej 900 Euro, për t'u mundësuar atyre të gjenin një banesë alternative. Shteti mori në zotërim banesën më 1 qershor 2011.

Ligji – Neni 1 i Protokollit Nr. 1: Konfiskimi në fjalë ishte parashikuar me ligj dhe ndiqej qëllimi me interes publik i luftës kundër trafikimit të drogës duke dekurajuar fshehjen e pasurisë së përfutur në mënyrë të paligjshme dhe pastrimit të parave. Në lidhje me personat që kanë qenë në kontakt të rregullt me një person të përfshirë në kryerjen e krimeve ose veprave penale që dënohen me burgim deri në pesë vjet dhe që nuk kanë qenë në gjendje të

tregonin që ata kanë pasur burime që të përputhen me stilin e jetesës së tyre ose të demonstrojnë origjinën e ligjshme të pasurive në zotërim të tyre, kuadri legjislativ ka përcaktuar një prezumim: personat e përfshirë janë prezumuar të kenë përfituar nga burimet ose pasurinë e përfutur në mënyrë mashtruese në dijeni të plotë të fakteve. Në një rast të tillë, të gjithë ose një pjesë e pasurive në lidhje me të cilat ata nuk janë në gjendje të shpjegojnë origjinën e tyre mund të konfiskoheshin si dënim shtesë. Prezumimi ishte i kundërshtueshëm dhe kërkuesit mund të evitonin dënimin nëse ata do të kishin demonstruar origjinën e ligjshme të burimeve dhe pasurive të tyre. Në të vërtetë, pas konstatimit që mënyra e jetesës së tyre nuk ishte në proporcion me të ardhurat e deklaruarat prej tyre, gjykatat vendase i kishin vlerësuar rregullisht provat e paraqitura në mbështetje të pretendimeve të tyre. Ajo mori gjithashtu parasysh sjelljen e kërkuesve, duke vënë re veçanërisht që ata nuk mund të mos ishin në dijeni të origjinës së parave që u jepeshin atyre nga i biri. E thënë në përgjithësi, asgjë nuk sugjeronte që kërkuesve, çështja e të cilëve ishte dëgjuar para dy shkallëve të gjykimit, të cilët kishin bërë ankim në lidhje me çështjet ligjore, dhe të cilët nuk pretendonin të ishin viktimat të një shkeljeje të së drejtës së tyre për një gjykim të drejtë, nuk u ishte dhënë mundësi e arsyeshme për t'ua paraqitur çështjen e tyre autoriteteve. Gjykata pranoi që dukej se një pjesë e financimit për blerjen e banesës së kërkuesve kishte një burim të ndryshëm nga trafikimi i drogës në të cilin ishte i përfshirë i biri i tyre. Vërtet, burimet e tyre pas vitit 2006 nuk ishin në diskutim. Kështu, pagesat e hipotekës pas vitit 2006 ishin mjete për financimin e blerjes që nuk e kishte origjinën nga trafikun e drogës për të cilën ata ishin dënuar. Megjithatë, nuk kishte asgjë të tepërt në përfundimin që “pjesa më e madhe” e këtyre pasurive ishin përfutur nga të ardhurat e trafikut të drogës në të cilin ishte i përfshirë i biri i tyre. Për më tepër, vendimi i gjykatave vendase për të konfiskuar banesën në tërësinë e saj si dënim demonstronte një dëshirë legjitime për të dënuar me ashpërsi veprat penale të kryera nga kërkuesit, që ishin të ngjashme me fshehjen e pasurive të përfutur në mënyrë të paligjshme dhe që, përveç kësaj, kishin ndodhur në kontekstin e trafikimit në masë të gjerë në nivel lokal. Duke ditur shkatërrimin e shkaktuar nga droga, ishte e kuptueshme që autoritetet e Shteteve Kontraktuese të jenë më të ashpër me ata që kontribuojnë në nxitjen e kësaj flame.

Kështu, ndërhyrja në të drejtën e kërkuesve për gëzimin paqësor të zotërimeve të tyre nuk ishte disproporcionale me ndjekjen e qëllimit të interesit të përgjithshëm.

Përfundimi: i papranueshëm (haptazi i pabazuar)

Neni 8: Shtëpia e konfiskuar ishte banesë familjare e kërkuesve. Masa në këtë mënyrë kishte ndërhyrë tek ushtrimi i së drejtës së tyre për të respektuar jetën e tyre private dhe familjare dhe banesën e tyre. Ndërhyrja ishte në pajtim me ligjin, synonte të luftonte trafikimin e drogës dhe të parandalonte atë nga dekurajimi i fshehjes së pasurive të përfutuara në mënyrë të paligjshme dhe pastrimin e parave dhe synonte ‘parandalimin e parregullsisë ose krimin’. Objekti i marzhit të vlerësimit të Shteteve ishte më i ngushtë në zbatimin e Neni 8 të Konventës krahasuar me zbatimin e paragrafit të dytë të Neni 1, Protokollit nr. 1. Megjithatë, autoritetet kishin marrë rregullisht parasysh situatën e kërkuesve duke i lejuar ata të mbeten në banesën e tyre deri në atë moment që ata të jenë në gjendje të transferohen në mjedise të tjera.

Përfundimi: i papranueshëm (haptazi i pabazuar)

NENI 4 I PROTOKOLLIT Nr. 7

E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë

Vazhdimi i procedimit për tatime dhe detyrime shtesë pas marrjes së pafajësisë nga taksapaguesja në lidhje me veprat penale tatimore që rrjedhin nga të njëjtët fakte: *shkelje*

Lucky Dev kundër Suedisë - 7356/10

Vendimi 27.11.2014 (Seksioni V)

Faktet – Në qershor 2004, autoritetet tatimore suedeze filluan procedimet penale ndaj kërkueses në lidhje me kompensimin e taksave mbi të ardhurat dhe TVSH-së për vitin 2002 dhe e urdhëroi atë të paguante taksa dhe detyrime shtesë. Kërkuesja e kundërshtoi këtë urdhër në gjykatë. Ajo u ndoq penalisht edhe për veprat penale të kontabilitetit dhe tatimore që rridhnin

nga i njëjta paketë e kompensimit të taksave. Megjithëse ajo u dënua për veprën penale në lidhje me kontabilitetin, ajo u shpall e pafajshme për veprat penale tatimore (për mungesë të qëllimit përkatës). Procedimi tatimor vazhdoi për një periudhë tjetër prej nëntë muajsh e gjysmë pas datës pasi shpallja e saj e pafajshme kishte marrë formë të prerë. Në kërkesën e saj tek Gjykata Evropiane, kërkujesja u ankua që si rezultat i ndjekjes penale dhe urdhërimit për të paguar detyrimet tatimore në lidhje me të njëjtat fakte, ajo ishte gjykuar dhe dënuar dy herë, në shkelje të Nenit 4 të Protokollit nr. 7.

Ligji – Neni 4 i Protokollit nr 7

- (a) Pranueshmëria – Në tre vendimet e fundit, duke përfshirë *Shibendra Dev kundër Suedisë* (7362/10, 21 tetor 2014, i përmbledhur sipas Nenit 35 par 1 më sipër, faqe 19), Gjykata kishte vendosur që mjetet e reja të ankimit që ishin ofruar në të drejtën e brendshme si rezultat i vendimeve të fundit të Gjykatës së Lartë Suedeze në lidhje me detyrimin për t’iu nënshtruar ndjekjes penale dhe detyrimeve tatimore mund të konsideroheshin tani efektive dhe duhej të ezauroheshin në çdo rast në të cilin paketa e procedimit që fillonte më vonë në kohë përfundonte në ose pas datës 10 shkurt 2009. Meqenëse paketa e dytë e procedimit (procedimi penal në rastin e kërkujeses) kishte përfunduar para asaj date, kërkujeses nuk i ishte kërkuar të përdorte këtë mjet.
- (b) Themeli – Gjykata përsëriti që procedimet që kishin të bënin me detyrimet tatimore duhej të konsideroheshin ‘penale’ jo vetëm për qëllimet e Nenit 6 të Konventës, por edhe për qëllimet e Nenit 4 të Protokollit nr 7. Kështu, si procedimet tatimore ashtu edhe ato penale në rastin e kërkujeses përfshiheshin në sferën e dispozitës së fundit. Neni 4 i Protokollit nr 7 e ndalonte ndjekjen penale ose gjykimin e një ‘vepre’ të dytë, nëse ajo rridhte nga të njëjtët fakte ose fakte që ishin thelbësisht të njëjtë. Elementët e veprës penale të kontabilitetit ishin në masë të mjaftueshme të ndara nga faktet që kishin shkaktuar detyrimet tatimore për t’i dhënë mundësi Gjykatës për të nxjerrë përfundimin që dënimi i kërkujeses për atë vepër penale nuk përbënte dënim të dyfishtë. Pozicioni në lidhje me ndjekjen penale për veprën penale tatimore ishte ndryshe: akuzat e kërkujeses dhe vendosja e detyrimeve tatimore shtesë bazohej në mosdeklarimin e të ardhurave nga biznesi dhe TVSH-së ndërsa procedimet tatimore dhe procedimet penale kishin të bënin me të njëjtën periudhë kohore dhe thelbësisht të njëjtën shumë të evazionit

fiskal. Për pasojë, faktet ishin të paktën të njëjtët. Kërkesa e vendimit ‘përfundimtar’ ishte përmbushur në masën që nuk ishte bërë asnjë ankim ndaj vendimit që shpallte të pafajshme kërkuesen për detyrimet tatimore, që tashmë kishte marrë fuqi ligjore. Nëse ka pasur dublifikim të procedimeve, Gjykata përsëriti që Neni 4 i Protokollit nr 7 nuk kufizohet tek e drejta për të mos u dënuar dy herë por shtrihej tek e drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën veprë penale. Pra ai zbatohet edhe nëse individi ishte ndjekur penalisht në një procedim që nuk ka përfunduar me dënim. Megjithatë, mbrojtja kishte fuqi pasi vendimi në lidhje me të njëjtën veprë penale të merrte formë të prerë: Neni 4 i Protokollit nr 7 nuk përjashtonte zhvillimin e disa paketave të procedimeve para se të ishte marrë vendimi përfundimtar. Një shkelje do të ishte nëse një paketë procedimesh do të vazhdonte pas datës në të cilën paketa tjetër kishte përfunduar me një vendim të formës së prerë. Procedimet tatimore në rastin e kërkueses nuk kishin përfunduar dhe detyrimet tatimore nuk ishin shfuqizuar pasi procedimi penal të kishte marrë formë të prerë, por në vend të kësaj, kishte vazhduar për një periudhë tjetër prej nëntë muajsh e gjysmë. Nuk ka pasur një lidhje të ngushtë në masë të mjaftueshme, në lëndë dhe kohë, ndërmjet të dy paketave të procedimeve që ato të shihen si pjesë e të njëjtës paketë sanksionesh (krahasoni pozicionin çështje të tilla si *R.T. kundër Zvicrës dhe Nilsson kundër Suedisë*, në të cilat Gjykata konstatoi që vendimet për heqjen e lejes së drejtimit bazoheshin drejtpërdrejt mbi një dënim të pritshëm dhe përfundimtar për veprën penale të trafikut rrugor dh në këtë mënyrë nuk përmbante një shqyrtim të veçantë të veprës penale ose sjelljes në fjalë). Në tërësi, kërkuësja ishte gjykuar ‘përsëri’, për një veprë penale për të cilën ajo ishte shpallur përfundimisht e pafajshme.

Përfundim: shkelje (njëzëri)

Neni 41: EUR 2,000 në lidhje me dëmin jo-financiar.

II. VENDIME TË VJETËR TË RËNDËSISHËM TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Çështja E Gutsanovit kundër. Bullgarisë - 34529/10

Vendim i datës 15 tetor 2013

Faktet: Kërkuesit, Z. Borislav Gutsanov, bashkëshortja e tij, zonja Monika Gutsanova, dhe dy vajzat e tyre të mitura, S. Dhe B. Gutsanovi, janë shtetase bullgare të cilët kanë lindur përkatësisht në 1967, 1972, 2002 dhe 2004 përkatësisht dhe banojnë në Varna. Z. Gutsanov është anëtar i parlamentit për Partinë Socialiste, Në periudhën përkatëse ai ishte edhe kryetar i këshillit bashkiak të Varnas.

Ndërmjet dhjetorit 2009 dhe prillit 2010, Ministria e Brendshme zhvilloi disa operacione policore që synonin shkrirjen e grupeve të ndryshme kriminale. Policia arrestoi një numër individësh, duke përfshirë disa figura politike. Më 30 tetor 2009, zyra e prokurorit publik të qytetit të Sofjes fillon një procedim penal ndaj një personi ose personave të panjohur për shkak të abuzimit me detyrën nga një punonjës i shërbimit publik dhe përvetësim të fondeve publike. Më 31 mars 2010, ora 6 30 para dite, policia hyri në banesën e familjes Gutsanovi dhe vijoi me arrestimin e Z. Gutsanov dhe kontrollin e mjediseve. Ishte nxjerrë një urdhër për ndalimin e Z. Gutsanov për njëzet e katër orë. Kur Z. Gutsanov u largua nga banesa e tij rreth orës 1 pas dite me eskortë policie, gazetarët dhe personeli televiziv ishte mbledhur jashtë banesës së tij. Prokurori rajonal i Varnës, komisionari i policisë dhe shefi i njësisë së krimit të organizuar dolën në një konferencë për shtyp. Ditën tjetër gazeta ditore rajonale publikoi komentet e prokurorit të përgjithshëm, së bashku me pjesë nga një intervistë me Ministrin e Brendshëm në lidhje me çështjen. Po ashtu, më 31 mars 2010, ora 10 55 pas dite, prokurori e akuzoi Z. Gutsanov për disa vepra penale duke përfshirë përfshirjen, në cilësinë e tij si punonjës i shërbimit publik, në një grup kriminal aktivitetet e të cilit realizonin dhënien e kontratave potencialisht në dëm të bashkisë, dhe abuzim me detyrën nga një punonjës i shërbimit publik. Prokurori urdhëroi ndalimin e Z. Gutsanov për shtatëdhjetë e dy orë me qëllim që të sigurohej prania e tij në gjykatë. Më 3 prill 2010, Z. Gutsanov u paraqit në gjykatë dhe u fut në paraburgim. Gjykata nuk iu referua ndonjë rreziku që ai mund të arratisë, por

konstatoi e ndalimi i tij në vazhdimësi justifikohet nga rreziku që ai mund të kryente vepra të tjera penale. Z. Gutsanov e ankimoi këtë vendim në Gjykatën e Apelit, pa sukses. Më 18 maj 2010, Gjykata Rajonale e refuzoi kërkesën për lirim të bërë nga kërkuesi, i cili e ankimoi vendimin në Gjykatën e Apelit. Kjo e fundit nxori një urdhër që e vendoste atë në arrest shtëpie. Më 26 korrik 2010 gjykata vendosi lirimin e Z. Z. Gutsanov pas lënies së garancisë. Meqenëse më 26 prill 2013, procedimi penal ndaj Z. Gutsanov nuk kishte përfunduar dhe ishte në fazën e hetimit paraprak. Edhe pse ankesat, procedura dhe përbërja e gjykatës janë mbështetur në nenin 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës), kërkuesit pretenduan që ata i ishin nënshtruar trajtimit poshtëruës si rezultat i operacionit të policisë në banesën e tyre. Sipas Nenit 5 (e drejta e lirisë dhe sigurisë), Z. Gutsanov pretendoi që ai nuk ishte sjellë menjëherë para gjyqtarit, që ai ishte mbajtur në burg për një periudhë të gjatë kohore që gjykatat vendase nuk i kishin dhënë atij shkaqe të përshtatshme dhe të mjaftueshme për ndalimin e tij në vazhdimësi dhe që ai nuk kishte akses tek asnjë mjet i brendshëm mbrojtjeje që t'i jepte mundësi atij të merrte kompensim për këto shkelje. Në mbështetje të nenit 6, par 2 (prezumimi i pafajësisë) dhe Nenit 13 (e drejta për një mjet mbrojtjeje të efektshëm), Z. Gutsanov u ankua që ankesat e bëra nga Kryeministri, Ministri i Mbrojtjes dhe prokurori rajonal kishin shkelur të drejtën e tij të prezumimit të pafajësisë. Ai gjithashtu u ankua për arsyet e dhëna për vendimin e datës 18 maj 2010, i cili urdhëron vazhdimin e ndalimit të tij.

Sipas Nenit 8 (e drejta e respektimit të banesës dhe jetës private dhe familjare) familja Gutsanov pretendoi që kontrolli i kryer në banesën e tyre përbënte ndërhyrje të pajustificuar në të drejtën e tyre për respektimin e banesës dhe jetës së tyre familjare.

Në mbështetje të nenit 13 (e drejta për një mjet mbrojtjeje të efektshëm), kërkuesit argumentuan që ata nuk kishin ndonjë mjet mbrojtjeje të efektshëm të brendshëm në lidhje me shkeljet e pretenduara të së drejtës së tyre për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës dhe të së drejtës së respektimit për banesën e tyre.

Vendimi i Gjykatës:

Neni 3

Gjykata vuri re që qëllimet e operacionit të policisë ishin një arrest, një kontroll dhe një sekuestrim i sendeve; këto qëllime ishin të përshtatshëm për të mbrojtur interesin publik në ndjekjen penale të veprave penale. Gjykata nënvizoi që megjithëse të katër anëtarët e familjes nuk kishin pësuar dëmtime fizike gjatë operacionit policor, ky i fundit megjithatë përmbante forcë fizike. Dera kryesore e banesës ishte hapur me forcë nga njësia e ndërhyrjes së shpejtë dh Z. Gutsanov u neutralizua nga punonjës të armatosur që kishin vënë maska, ishte ulur me forcë dhe i ishin vënë prangat. Z. Gutsanov ishte kryetari i këshillit bashkiak të Varnas dhe ishte figurë e mirë-njohur politike në qytet. Nuk kishte prova që do të nënkuptonin që ai kishte të shkuar të dhunshme dhe mund të përbënte një rrezik për punonjësit e policisë. Ishte e vërtetë që ai zotëronte një armë zjarri dhe municion; megjithatë, Gjykata konsideroi që prania e një arme në banesën e kërkuesve nuk mund të justifikonte angazhimin e njësisë së ndërhyrjes së shpejtë ose llojin e forcës që u përdor. Gjykata theksoi që prania e mundshme e anëtarëve të familjes në momentin e arrestit ishte një faktor që duhet të merret parasysh në planifikimin dhe zbatimin e këtij lloji operacioni. Për më tepër, bashkëshortja e Gutsanovit nuk ishte e dyshuar dhe dy vajzat e tyre ishin psikologjikisht të cenueshme pasi ata ishin të vogla (5 dhe 7 vjeç). Duket se zonja Gutsanova dhe vajzat e saj u prekën shumë nga këto ngjarje. Ndjenja e frikës dhe ankthit që këto tre kërkuese përjetuan bënë që Gjykata të nxirrte përfundimin që ato i ishin nënshtruar një trajtimi poshtërues. Operacioni policor ishte planifikuar dhe zbatuar pa marrë parasysh numrin e faktorëve duke përfshirë natyrën e veprave penale për të cilat dyshohej Z. Gutsanov, faktin që ai nuk kishte të shkuar të dhunshme dhe praninë e mundshme të bashkëshortes dhe vajzave të tij në banesë. Të gjithë këta elementë tregonin qartazi që mjetet e përdorura për të arrestuar Z. Gutsanov në banesën e tij ishin të tepruara; për pasojë, ai gjithashtu i ishte nënshtruar trajnimit poshtërues.

Neni 5 §§ 3 dhe 5

Z. Gutsanov u arrestua më 31 mars 2010, ora 6 30 para dite, dhe doli para gjyqtarit tre ditë, pesë orë dhe tridhjetë minuta më vonë. Së pari, Gjykata vuri re që Z. Gutsanov kishte qenë i dyshuar në një çështje në lidhje me përfitimin e fondeve publike dhe abuzimin me detyrën, por ai nuk ishte dyshuar për

përfshirje në aktivitete të dhunshme kriminale. Gjatë ditës së parë të ndalimit të tij, Z. Gutsanov kishte marrë pjesë në disa masa hetimore; megjithatë, Qeveria nuk kishte paraqitur ndonjë argument për të justifikuar faktin që ai nuk ishte nxjerrë para një gjyqtari në ditën pas arrestit ose akuzës. Kështu ka pasur shkelje të Nenit 5 par 3.

Së dyti, gjykata vëzhgoi që Z. Gutsanov ishte privuar nga liria për katër muaj, dy muaj nga të cilët i kishte kaluar në arrest shtëpie. Edhe në momentin e kërkesave të tij fillestare për lirim, gjykatat vendase e kishin përjashtuar rrezikun e arratisjes prej tij. Megjithatë ato urdhëruan ndalimin e tij në vazhdimësi për shkak se ai mund të kryente vepra të tjera penale, veçanërisht duke manipuluar provat. Gjykata e Apelit, në vendimin e datës 25 maj 2010, pati mendimin që rreziku i fundit nuk vazhdonte të ekzistonte duke pasur parasysh dorëheqjen e kërkuesit nga pozicioni i mëparshëm si kryetari këshillit bashkiak. Z. Gutsanov, megjithatë, u vendos në arrest shtëpie, ndërsa Gjykata e Apelit nuk dha ndonjë shkak specifik që të justifikonte masën, që kishte mbetur në fuqi për dy muaj. Për pasojë, Gjykata nxori përfundimin që autoritetet nuk e kishin përmbushur detyrimin e tyre për të justifikuar ndalimin në vazhdimësi të kërkuesit pas datës 25 maj 2010. Ajo gjeti një shkelje tjetër të Nenit 5, par 3.

Në lidhje me masat e mundshme të brendshme, Gjykata mendoi që padia për rikuperim dëmi e parashikuar në ligjin për përgjegjësinë e Shtetit nuk mund të konsiderohet një mjet mbrojtës i efektshëm i brendshëm. Në dijeninë e Gjykatës, asnjë dispozitë tjetër nuk ekziston në legjislacionin e brendshëm nëpërmjet së cilës mund të merret kompensim për dëmin e pësuar në lidhje me kohëzgjatjen e tepër të ndalimit ose një vonesë në sjelljen para gjyqtarit. Gjykata në këtë mënyrë konsideroi që ka shkelje të Nenit 5, par 5.

Neni 6 § 2

Gjykata nuk është e mendimit që komentet e Kryeministrit në media synonin të cenonin të drejtën e Z. Gutsanov për t'u prezumuar pa faj apo që e kanë pasur këtë efekt. Po ashtu, ajo nuk konstatoi që deklaratimet e bëra nga prokurori rajonal i Varnës në konferencë për shtyp kishin shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë. Përkundrazi, komentet e bëra nga Ministri i Brendshëm një ditë pas arrestimit të Z. Gutsanov dhe që ishin publikuar në një gazetë në momentin kur çështja ishte objekt i interesit të fortë publik kishin shkuar tej dhënies së informacionit. Sipas mendimit të Gjykatës, komentet e

Ministrit dukeshin sikur i jepnin publikut përshtypjen që Z Gutsanov ishte një nga “drejtuesit” pas grupit kriminal që kishte përvetësuar shuma të mëdha nga paratë publike. Gjykata nxori përfundimin që komentet kishin shkelur të drejtën e Z Gutsanov për t’u prezumuar i pafajshëm.

Në lidhje me shkakun për vendimin që urdhëronte ndalimin në vazhdimësi të Z Gutsanov, gjyqtari kishte deklaruar që gjykata ‘mbetet e mendimit që ishte kryer një vepër penale dhe që i akuzuari ishte i përfshirë’. Sipas mendimit të Gjykatës, kjo frazë është e barabartë me deklarinimin e fajit para se të merrej ndonjë vendim për themelin dhe kishte shkelur të drejtën e Z. Gutsanov për t’u prezumuar pa faj.

Neni 8 § 2

Kontrolli ishte bërë pa autorizim paraprak gjyqësor. Raporti i përpiluar pas kontrollit ishte paraqitur para gjyqtarit në gjykatë, i cili formalisht e aprovoi atë, por nuk dha shkaqe.

Sipas Mendimit të Gjykatës, kjo nuk përbën shkaqe të mjaftueshme për të konstatuar që gjyqtari kishte kryer një rishikim të efektshëm të ligjshmërisë dhe domosdoshmërisë së kontrollit. Për më tepër, ndërsa hetimi penal ishte hapur pesë muaj më parë, hetuesit mund të bënin kërkesë për një urdhër gjykate para kryerjes së kontrollit.

Gjykata është e mendimit që në mungesë të aprovimit paraprak nga një gjyqtar dhe të rishikimit prapaveprues të një masë në fjalë, procedura nuk është respektuar nëpërmjet garancive të mjaftueshme për të parandaluar rrezikun e abuzimit me kompetencat nga ana e autoriteteve të hetimit penal. Kërkuesve efektivisht u ishte hequr mbrojtja përkatëse ndaj arbitraritetit dhe për pasojë ka pasur shkelje të Nenit 8, par 2.

Neni 13 në lidhje me Nenet 3 dhe 8

Gjykata vuri re që as një ankesë penale dhe as një padi për rikuperim dëmi kundër Shtetit nuk mund të thuhet se përbën një mjet mbrojtës të brendshëm dhe të përshtatshëm. Ajo vuri në dukje që fakti i shkaktit të vuajtjes psikologjike nuk përbente një vepër penale sipas ligjit të brendshëm, për pasojë një ankim penal i mundshëm nga kërkuesit do të ishte e destinuar të dështonte. Kërkuesit nuk kishin në dispozicion ndonjë mjet mbrojtës nëpërmjet të cilit të ndiqnin të drejtën e tyre për të mos iu nënshtruar

trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës ose të drejtën e tyre për respektimin e banesës.

Kështu Gjykata konstatoi shkelje të Nenit 13 të lexuar në lidhje me Nenet 3 dhe 8.

Kompensimi i drejtë (Neni 41)

Gjykata është e mendimit që Bullgaria duhej t'u paguante kërkuësve së bashku 40,000 Euro në lidhje me dëmin e tyre jo-pasuror dhe 4,000 Euro në lidhje me koston dhe shpenzimet.

III. AKTGJYKIME KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

III.1 Kitanovski kundër RM-së, A. nr. 15191/12 (aktgjykim i GJEDNJ i datës 15 janar të vitit 2015)

Shkelje të nenit 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore (KEDNJ).

Lënda pason nga aplikimi (nr. 151191/12) i parashtruar nga ana e dy shtetasve të Maqedonisë, z. Aleksandar Kitanovski (“ankuesi i pare”) dhe z. Tihomir Kitanovski (“ankuesi i dytë”) më datën 9 mars të vitit 2012. Ankuesi i dytë është babai ankuesit të pare. Dy ankuesit në ankesën e tyre kanë theksuar se gjatë kohës së incidentit i cili ka ndodhur më 10 qershor të vitit 2009, nëpunësit e policisë kanë rrezikuar jetën e ankuesit të pare, e kanë keqtrajtuar dhe se nuk është zhvilluar hetim efikas për rastin konkret. Përkatesisht ata janë ankuar, në pajtim me nenin 2 të Konventës, jeta e ankuesit të parë ka qenë e rrezikuar, dhe se ai ka qenë i keqtrajtuar nga ana e nëpunësve të policisë, të cilët e kanë rrahur me shkopinj, e kanë goditur dhe shkelmuar nëpër fytyrë, në kokë, në pjesën e stomakut dhe në shpinë. Ata, më pas janë ankuar në bazë të këtij neni se nuk është realizuar procedure efikase hetimore në lidhje me pohimet e tyre nga ana e prokurorit publik, meqenëse i njëjti nuk ka sjell aktvendim formal për refuzim të kallëzimit penal, ashtu siç parasheh LPP.

Versioni qeveritar i ngjarjeve

Më 10 qershor të vitit 2009, rreth orës 1:30 pas mesnatës, ankuesi i pare duke drejtuar automobilin i cili ka qenë në pronësi të ankuesit të dytë, është kthyer në shtëpi nga diskoteka. Në qendrën e Shkupit, dy nëpunës të uniformuar të policisë së trafikut, i kanë urdhëruar që ta ndaloj automjetin për kontrollim rutinorë. Në vend që të ndaloj, ankuesi i parë ka lakuar automjetin në formë të shkronjës U dhe ka përshpejtuar automjetin. Pas kësaj ka filluar ndjekja policore pas automjetit. Janë vendosur dy bllokada me qëllim që të ndalohet automjeti. Bllokadën e parë, ankuesi e ka evituar dhe ka vazhduar që të drejtoj automjetin me shpejtësi të madhe. Gjatë përpjekjeve që të evitohet edhe bllokadën e dytë, ankuesi është ngjitur në trotuar nga ana e majtë e rrugës,

me ç'rast Z.G. nëpunës i policisë nga njësitë "Afla", i cili ka qëndruar nga ana e kundërt e rrugës afër bllokadës, ka shtënë dy herë nga pushka automatike në drejtim të rrotës së djathtë të parme të automobilit. Automjeti i ankuesit të parë është ndaluar në një largësi prej 100 metrave pas bllokadës rrugore. Sipas letrës së datës 21 nëntor të vitit 2009, nëpunësit policorë i janë afruar automjetit dhe njëri prej tyre ka drejtuar pistoletën në drejtim të tij. Meqenëse ankuesi i parë nuk ka dalë nga automjeti, atij ia ka lakuar dorën prapa shpinës, e ka tërhequr nga automjeti dhe e ka shtrirë për toke në rrugë.

Versioni i ngjarjeve sipas ankuesve

Në ankesën e tyre, ankuesit kanë theksuar se në ora 2:15 minuta pas mesnatës, më datën 10 qershor të vitit 2009, ankuesi i parë, duke drejtuar automjetin e ankuesit të dytë, ai ka kaluar përkaj patrullës policore të trafikut dhe ka filluar të lëviz me automjetin prapa (rikuerc) me qëllim që të arrij deri te restoranti për ushqim të shpejtë. Nëpunësit e policisë, të njësitit mobil "Alfa" kanë filluar ta ndjekin me automjetin e policisë nëpër rrugët e Shkupit. Pastaj është vendosur bllokadë rrugore me automjet të pashënuar me qëllim që ta ndalojnë atë. Pasi që e ka evituar bllokadën, nëpunësit e policisë kanë filluar me të shtëna drejtë automjetit me pistoletë dhe me pushkë automatike me të shtëna batore "pa kurrfarë arsye – vetëm ndoshta për arsye se ka evituar kontrollimin rutinorë dhe nuk ka ndaluar automjetin para bllokadës prej automjeteve të pashënuara të vendosura nga njësitë "Alfa". Si rezultat i kësaj, automjeti ka qenë i dëmtuar. Ankuesi i parë ka ndaluar automjetin pas të shtënave nga policia. Ai ka qenë i tërhequr nga automjeti nga disa nëpunës policorë, të cilët kanë filluar ta godasin nëpër tërë trupin. Ai është goditur me shkopinj, ata e kanë goditur nëpër fytyrë, kokë, stomak dhe në shpinë. Atij i kanë vendosur prangat dhe më pas kanë vazhduar ta rrahin edhe pas kësaj.

Kallëzimi penal nga ankuesi i parë

Më 14 korrik të vitit 2009, ankuesi i dytë, në emër të ankuesit të parë, ka dorëzuar kallëzim penal deri te prokurori publik, kundër nëpunësve të pidentifikuar të policisë, për shkak të kërcënimit, torturës dhe sjelljes jo njerëzore. Në mes 31 marsit të vitit 2010 dhe 21 qershorit të vitit 2011, ankuesi i parë i është drejtuar prokurorit publik katër herë me radhë, duke

kërkuar nisjen e procedurës penale, ashtu siç parashikon ligji. Më 23 janar të vitit 2013 A.M. ka sjell vendim me të cilin ka refuzuar kallëzimin penal në emër të ankuesit të parë, në bazë të faktit se veprat e theksuara penale, nuk janë vepra për të cilat inicohet procedura e ndjekjes në pajtim me detyrën zyrtare.

Kallëzim penal kundër ankuesit të parë

Më 29 shtator të vitit 2009, Ministria e punëve të brendshme deri te prokurori publik ka dorëzuar kallëzim penal kundër ankuesit të parë për sulm mbi nëpunësin e policisë gjatë ushtrimit të detyrave të tij. Më 1 prill të vitit 2011, prokurori publik ka dorëzuar akuzë kundër ankuesit të parë.

Më 3 dhjetor të vitit 2013, Gjykata themelore Shkup, në prani të ankuesit të parë dhe A.M., në veti të përfaqësuesit të prokurorisë, ka konstatuar se ankuesi i parë është fajtor për sulmin e kryer mbi nëpunësin e policisë gjatë realizimit të aktiviteteve punuese për sigurinë publike, që ka të bëjë me kapjen e shkelësit të veprës penale. Gjithashtu, ai ka qenë i gjykuar me gjykim të kushtëzuar në kohëzgjatje prej një viti dhe gjashtë muaj. Gjatë gjykimit, ankuesi i parë ka theksuar se gjatë kohës së ndjekjes policore, ai ka evituar dy bllokadat duke u ngjitur në trotuarin nga ana e majtë e rrugës, në vendin ku nuk ka qenë i pranishëm nëpunësi i policisë. Prej kësaj, me evitimin e bllokadës, ai as që ka lënduar e as cenuar jetën e nëpunësit të policisë. Gjykata ka refuzuar konstatimin e mbrojtjes për arsye se i njëjti është në favor të palës së akuzuar.

Ankuesi i parë ka parashtruar ankesë në lidhje me aktgjykimin e sjellë. Në seancën publike gjyqësore, të mbajtur më datë 19 mars të vitit 2014, Gjykata e apelit ka pranuar ankesën e ankuesit të parë dhe ka rikthyer rastin në shqyrtim të sërishëm. Procedura penale, është akoma në rrydhë.

Arsyetimet e dhëna nga GJEDNJ

Në lidhje me incidentin me të shtënat më 10 qershor të vitit 2009

Gjykata përsërit faktin se neni 2, i cili mbron të drejtën e jetës dhe i thekson rrethanat nën të cilat arsyetohet marrja e jetës, radhitet si një prej dispozitave fundamentale të Konventës. Situatat në të cilat marrja e jetës mund të

arsyetohet janë decide dhe duhet të interpretohet në mënyrë koncize. Shfrytëzimi i forcës, që mund të rezultojë me marrjen e jetës, duhet të jetë “absolutisht e domosdoshme” për realizimin e një prej qëllimeve të theksuara në nenin 2 paragrafi 2, nën (a), (b) dhe (c).

Gjykata tani më ka konstatuar se, duke pasur parasysh rrethanat në të cilat jeta e ankuesit të parë ka qenë e rrezikuar, si dhe natyrën e sjelljes së kontestuar të agjentëve shtetërorë në fjalë, faktet kërkojnë hulumtime në pajtim me nenin 2 të Konventës. Sipas kësaj, duhet të përcaktohet se vallë përdorimi i forcës potenciale vdekjeprurëse të shfrytëzuar kundër ankuesit të parë ka qenë e arsyeshme në rrethanat e shfaqura në rastin konkret, në kuptim të nenit 2 paragrafi 2 (a) dhe (b) të Konventës.

Për sa i përket rrethanave relevante të incidentit, Gjykata vëren se deri më tani nuk është realizuar përcaktimi gjyqësor i fakteve në lidhje me rastin e shqyrtuar në nivel kombëtarë.

Kallëzimi penal, i dorëzuar në lidhje me incidentit kundër nëpunësve të policisë, nuk rezulton me kurrfarë rezultate e as fakte, por as me të drejtën nga ana e gjykatave vendore deri sa rasti penal kundër ankuesit të parë është akoma në rrjedhë.

Gjykata vëren se ankuesi i parë, ka drejtuar automjetin nëpër qendrën e Shkupit në çastin kur i është afruar patrullës policore të trafikut. Palët kanë prezantuar versione të kundërta të ngjarjeve, për nga aspekti i asaj se vallë është drejtuar sinjalizimi me bateri që të ndalohet automjeti për inspektim rutinorë. Prapëseprapë, ankuesi i parë ka pranuar faktin se ndoshta ai ka evituar kontrollimin inspektues rutinorë nga ana e patrullës policore të trafikut. Në vend që të ndaloj automjetin, ai ka përsheptuar dhe ka vazhduar qarkullimin e automjetit. Refuzimi i ankuesit të parë, që të ndaloj automjetin ka shkaktuar ndjekje spontane policore, që ka përfshirë disa automjete policore dhe së paku pesëmbëdhjetë nëpunës të policisë. Ai nuk ka ndaluar automjetin dhe ka vazhduar edhe më tej të drejtoj automjetin me shpejtësi të zmadhuar nëpër rrugët e Shkupit. Në rrethana të tilla, policia ka shfrytëzuar masat alternative që ta detyrojë ankuesin e parë që ta ndaloj automjetin, përkatësisht ata i kanë vendosur dy bllokada, secila prej tyre e përbërë prej një automjeti policorë. Dy bllokadat, ashtu siç ka qenë e konstatuar, janë treguar si jo përkatëse që ta ndalojnë ankuesin e parë, i cili i ka evituar të njëjtit dy herë me radhë. Gjykata nuk anashkalon faktin se policia nuk ka

pasur kohë të mjaftueshme që ti vlerësojë të gjitha parametrat e situatës, gjë që ka rezultuar me zhvillimin e ngjarjeve që ata të urdhërohen që të reagojnë pa përgatitje paraprake.

Incidenti i ankuar i të shtënave, është manifestuar gjatë bllokadës së dytë, drejtë së cilës, automjeti i ankuesit të parë i është afruar me një shpejtësi tejet të madhe. Ankuesi i parë është orvatur që ta tejkaloj bllokadën duke u ngjitur në trotuar.

Gjatë procedurës penale kundër tij, ai ka pohuar, në mënyrë eksplicite, se është ngjitur në trotuar “ku nuk ka qëndruar asnjë nëpunës i policisë”. Lëshimi i gjykatës gjyqëse gjatë konstatimit të këtij fakti me një qartësi të mjaftueshme, ka qenë shkak që Gjykata e apelit në Shkup të vendos rikthimin e lëndës në shqyrtim të sërishëm. Gjykata e instancës më të lartë, ka konsideruar se ky fakt është me relevancë që të përcaktohet se vallë ankuesi i parë ka pasur ndonjë qëllim që të shkaktoj veprën penale të shqyrtuar.

Për nga aspekti i faktit se vallë përdorimi i forcës potenciale vdekjeprurëse ka qenë e paevitueshme “me qëllim të arrestit ligjor” të ankuesit të parë, në kuptim të pikës (b) të paragrafit 2 të nenit 2, Gjykata përsërit se qëllimi legjitim gjatë realizimit të arrestit ligjor, mund të arsyetoj cenimin e jetës së njeriut vetë gjatë rrethanave të domosdoshmërisë absolute. Gjykata konsideron se parimisht nuk mund të shfaqet domosdoshmëri e tillë, në rastet kur dihet se personi i cili duhet të arrestohet nuk paraqet kërcënim mbi jetën ose trupin dhe i cili nuk është i dyshuar për kryerje të veprave të dhunshme, goftë edhe në rastet kur lejimi i përdorimit të forcës vdekjeprurëse, mund të rezultojë që të humbet mundësia që të arrestohet i arratisuri.

Provat e prezantuara para Gjykatës, sugjerojnë se ankuesi i parë ka drejtuar automjetin me shpejtësi të tepruar. Prapëseparë, edhe përkaj faktit të incidenteve akoma kontestuese, të shfaqura kur ai ka kaluar përmes bllokadave, nuk është ofruar dëshmi se gjatë kohës së ndjekjes policore, ai në ndonjë mënyrë ka cenuar jetën e nëpunësve të policisë ose të personave të tjerë. Në mënyrë plotësuese, nëpunësve të policisë të përfshirë në ndjekjen nuk u është kumtuar kurrfarë informacioni në lidhje me aktivitetet penale të ankuesit të parë ose për automjetin, edhe përkaj faktit se ka pasur kohë të mjaftueshme që një informacion i tillë të përcillet. Qendra kontrolluese, përmes së cilës është organizuar operacioni i ndjekjes, nuk ka dhënë paralajmërime se ankuesi i parë mund të jetë i armatosur ose i rrezikshëm. Në

rrethana të tilla, fakti se ngjarjet janë zhvilluar gjatës natës, edhe pse mund të pranohet si fakt relevant, nuk mund të merret si fakt i mjaftueshëm, në mungesë të çfarëdo dëshmie tjetër objektive, që do të arsyetonin bindjen e policisë se ankuesi i parë ka qenë kriminel i rrezikshëm. Përfundimisht, policia ka mundur të konstatoj, në bazë të targave të automjetit, të cilat nuk kanë qenë të paraqitura si të vjedhura, se cili është identiteti i pronarit të automjetit dhe adresa e tij, si dhe të dhënat e njëjta për ankuesin e parë. E lartpërmendura, së bashku me mungesën e rrezikimit të jetës dhe rrezikimet trupore, pasi që ka kaluar bllokadën e dytë, janë të mjaftueshme që Gjykata të sajojë konkludimin se përdorimi i forcës potenciale vdekjeprurëse kundër ankuesit të parë, sjellja e të cilit gjithsesi është e papërgjegjshme dhe meritore për tu kritikuar, nuk ka qenë absolutisht e domosdoshme për arrestimin e tij.

Përfundimisht, Gjykata vëren se të shtënat nga personat M.D. dhe Z.G. nuk kanë qenë të përcjella me të shtëna paralajmëruese, ashtu siç parashikohet me të drejtën ndërkombëtare dhe vendore dhe nga praktika e Gjykatës. Gjatë kësaj, nuk u prezantua ndonjë argument se të shtënat paralajmëruese, gjatë këtyre rrethanave kanë qenë të pamundshme ose jo përkatëse në ndonjë mënyrë tjetër.

Përkundër këtyre fakteve, Gjykata konstaton se në rastin e shqyrtuar, përdorimi i forcës potenciale vdekjeprurëse nuk ka qenë absolutisht e domosdoshme në kuptim të nenit 2, paragrafi 2 të Konventës. Sipas kësaj, ankuesi i parë ka qenë viktimë e shkeljes së këtij neni, për nga aspektet esenciale të tij.

Në lidhje me maltretimet e theksuara të ankuesit të parë gjatë kohës së arrestimit të tij

Gjykata përsërit faktin se neni 3 mbron njërën prej vlerave fundamentale të shoqërisë demokratike. Ky nen me terme absolute ndalon torturën ose veprimet jo humane ose nënçmuese gjatë veprimit ose dënimit. Më pas, neni përkujton se veprimet jo humane duhet të jenë në nivele minimale të peshës që të përfshihen nga përmbajtja e nenit 3.

Në lidhje me rastin konkret, Gjykata konstaton se është e pamohueshme se ankuesi i parë ka pësuar lëndime të caktuara trupore, të cilat kanë qenë të evidentuara në vërtetimin mjekësorë. Qeveria nuk ka konstatuar se këto

lëndime kanë arritur nivelin minimal që kërkohet sipas nenit 3 të Konventës, dhe se këto lëndime i janë shkaktuar ankuesit gjatë arrestimit të tij më datën 10 qershor të vitit 2009 (pasi ka ndaluar automjetin e tij). Sipas kësaj, Gjykata duhet të përcaktoj se vallë trajtimi të cilit i është nënshtruar ankuesi është kompatibil me këtë nen, përkatësisht vallë përdorimi i forcës fizike ka qenë rreptësisht i domosdoshëm dhe proporcional.

Gjykata vëren se palët nuk kontestojnë faktin se pasi që automjeti ka qenë i bllokuar, se ankuesi ka qenë i nxjerr nga automjeti nga nëpunësit e njësitit “Alfa”. Sipas Qeverisë, kjo ka qenë kështu për arsye se ai ka refuzuar që të dalë nga automjeti ashtu siç i është urdhëruar nga nëpunësit e policisë të përfshirë në ngjarjen. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se nuk i janë prezantuar dëshmi tjera të cilat do të përkrahnin versionin e ngjarjeve të prezantuara nga Qeveria. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se asnjëri prej njëzet nëpunësve të policisë, ashtu siç pohon Qeveria, të cilët kanë qenë dëshmitarë të arrestimit të ankuesit, asnjëri prej tyre nuk ka gjeneruar ndonjë dëshmi në këtë drejtim. Deklaratat me shkrim të dhëna nga nëpunësit e policisë, si pjesë e dosjes së rastit, po ashtu nuk përmbajnë ndonjë informacion në drejtim të asaj se vallë ankuesi ka rezistuar gjatë arrestimit të tij. Në rrethana të tilla, dhe për nga aspekti i faktit se faktet e kontestit të shqyrtuar nuk kanë qenë lëndë e çfarëdo lloji të vendosjes nga ana e gjykatës kombëtare, Gjykata nuk konsideron se Qeveria ka demonstruar argumente bindëse në favor të pohimit se përdorimi i forcës, që rezultoi me shkaktimin e lëndimeve të ankuesit, ka qenë e detyrueshme dhe proporcionale. Sipas kësaj, Gjykata konkludon se përdorimi i forcës ka qenë tej mase dhe i paarsyeshëm në rrethanat e shfaqura.

Prej këtui, mund të konstatohet se ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës në lidhje me trajtimin e ankuesit gjatë kohës së arrestimit të tij dhe për të cilin Gjykata konsideron se ka qenë degradues në kuptim të kësaj dispozite.

Mungesa e theksuar e hetimit efikas

Në rastet kur personi do të inicioj konstatim të qëndrueshëm se ka pësuar trajtim në kundërshtim me nenet 2 dhe 3 nga forcat policore ose nga agjentët tjerë të ngjashëm shtetërorë, këto dispozita, të lexuara së bashku me detyrimet e përgjithshme të shtetit, në pajtim me nenin 1 “ti siguroj secilit në suaza të kompetencave të saja, të drejtat dhe liritë e përcaktuara

në....Konventën”, sipas implikimeve nënkupton se duhet të realizohet hetimi efektiv zyrtar nga ana e prokurorisë publike.

Në rastin konkret, Gjykata vëren se më 14 korrik të vitit 2009, ankuesi i parë ka parashtruar kallëzim penal deri te prokurori publik, kundër nëpunësve të pa identifikuar të policisë.

Prokurori publik ka qenë i detyruar që të hulumtojë se vallë është shkaktuar vepra penale. Prapëseprapë, ai nuk ka ndërmarrë kurrfarë veprime hetimore, me përjashtim të asaj që ka kërkuar informacione plotësuese nga Ministria e punëve të brendshme. Prokurori publik nuk ka bërë përpjekje që ta marrë në pyetje ankuesin e parë, nëpunësit e policisë të përfshirë në rastin, ose ndonjë person tjetër i cili do të mund të ofronte informacione relevante dhe ti sqarojë faktet lidhur me rastin.

Më 23 janar të vitit 2013, po i njëjti prokurorë publik (A.M) ka miratuar konkluzionin e njëjtë dhe ka refuzuar parashtrësën e dorëzuar nga ankuesi i parë, kësaj radhe me vendim formal të përcjell me mësimin juridik se ndjekjen mund ta marrë në veti të paditësit subsidiarë.

Gjykata vëren se A.M. ka përfaqësuar zyrën e prokurorisë në procedurën penale kundër ankuesit të parë. Sipas vlerësimeve të Gjykatës, fakti se po i njëjti prokurorë i cili ka dorëzuar akuzën penale kundër ankuesit të parë, po i njëjti e ka shqyrtuar parashtrësën e tij, shton dyshimet për paanshmërinë e tij.

Duke pasur parasysh faktin se faktet e prezantuara lidhur me këtë lëndë, Gjykata konkludon se nuk ka pasur hetime efektive lidhur me konstatimet e ankuesit të parë se policia ka përdorur forcën vdekjeprurëse dhe se e ka torturuar të njëjtin.

Prej këtu, Gjykata konstaton se janë bërë shkelje të nenit 2 dhe 3 të Konventës, në pjesën procedurale.

Ankuesi i parë, ka kërkuar 4.000 euro, në emër të dëmit materiale dhe 50.000 euro në emër të dëmit jo material për vuajtje mentale, për dhembjen dhe frustracionet që i ka pësuar si rezultat i lëndimeve të shkaktuara. Qeveria i ka kontestuar këto kërkesa të ankuesit si të pabaza.

Qeveria më pas kanë theksuar se nuk ekziston lidhja kauzale në mes dëmshpërblimit të kërkuar dhe lëndimet e theksuara.

Ankuesi, gjithashtu ka kërkuar 2.000 euro për shpenzimet që i ka realizuar në lidhje me përfaqësimin juridik para pushtetit vendor (të llogaritur sipas Çmimoreve të Odës së avokatëve) dhe 5.900 euro për shpenzimet e realizuara për përfaqësim para Gjykatës. Shuma e fundit ka të bëjë me shpenzimet juridike për 200 orë të shërbimeve juridike. Ai ka kërkuar çfarëdo lloji i kompensimeve në këtë bazë ti paguhet avokatit të tij. Qeveria i kontestoi kërkesat e lartpërmendura si të pa baza dhe të tepruara.

Gjykata, ankuesit të parë i ka përcaktuar shumën prej 9.000 euro si dëmshpërblim jo material dhe 950 euro në emër të shpenzimeve.

III.2 Familja Mitovi kundër RM-së, A. nr. 53565/13 (aktgjykimi i GJEDNJ i datës 16 prill të vitit 2015)

Shkelja e nenit 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore (KEDNJ)

Lënda pason nga aplikacioni (nr. 53565/13) i dorëzuar nga ana e tre banorëve, z. Marjan Mitov (“ankuesi i parë”), zonja Cveta Mitova (“ankuesi i dytë”) dhe z. Denço Mitov (“ankuesi i tretë”) më datë 20 gusht të vitit 2013. Ankuesi i dytë dhe i tretë janë prindër të ankuesit të parë. Që të tre ankuesit posedojnë shtetësi të Maqedonisë dhe të Bullgarisë.

Ankuesit në ankesën e tyre, janë ankuar në pajtim me nenin 6 dhe 8 të Konventës, përkatësisht ata kanë theksuar se organet vendore kanë dështuar që ti zbatojnë aktvendimet e Qendrës për punë sociale lidhur me të drejtat e tyre që të mbajnë kontaktet me vajzën e tyre të mitur, vajzën e ankuesit të parë, M.M.

Përkatësisht, ankuesi i parë ka qenë në lidhje martesore me zonjën J.S.M, dhe gjatë kësaj lidhjeje martesore në vitin 2010 ka lindur vajza e tyre M.M. Pas divorcit në muajin maj të vitit 2012, Qendra për punë sociale ka miratuar më shumë aktvendime me të cilat i ka rregulluar çështjet lidhur me takimet nga ana e ankuesit të parë me vajzën e mitur të tij. Në kërkesë të ankuesit të dytë dhe të tretë, Qendra ka miratuar aktvendime me të cilin i ka rregulluar edhe takimet e ankuesit të dytë dhe të tretë me mbesën e tyre M.M. Megjithatë

zonja J.S.M. (e ëma e vajzës së mitur M.M.) nuk i ka respektuar këto aktvendime, dhe ajo nuk e ka dërguar vajzën e saj në terminet e përcaktuar për takime. Për këtë arsye aktvendimet nuk janë realizuar, dhe më pas ankuesit kanë qenë të privuar nga e drejta e kontakteve të pa penguara me vajzën e mitur M.M. Edhe përkaj drejtimit deri te institucionet vendore, të njëjtit janë prononcuar si jo kompetent për nga aspekti i zbatimit të aktvendimeve të sjella nga Qendra për punë sociale. Kundër zonjës J.S.M është iniciuar procedura penale për marrjen e personit të mitur dhe gjatë kësaj ajo është shpallur si fajtores dhe asaj i është shqiptuar dënimi i burgimit të kushtëzuar.

Arsyetimet e GJEDNJ

Në lidhje me shkeljet e theksuara të nenit 8 të Konventës

Duke i pasur parasysh rrethanat e rastit, si dhe pohimet ankuese të dorëzuara nga ana e ankuesve, Gjykata ka vërejtur se Qendra ka miratuar shtatë aktvendime me të cilat i ka rregulluar të drejtat e ankuesve lidhur me kontaktet me M.M. Gjykata gjithashtu ka vërejtur prolongime të mëdha të Qendrës gjatë vendosjes në lidhje me kërkesat e dorëzuara nga ankuesit që ti realizojnë kontaktet me M.M. (është nevojitur koha prej dy deri në pesë muaj që Qendra të vendos në lidhje me kërkesat e ankuesve). Për prolongimet e tilla, nuk janë ofruar kurrfarë arsyetime. Periudha e tillë ka qenë tejet e gjatë, në veçanti për nga aspekti i ankuesit të parë, qëndrimi i të cilit në Shtetin e paditur ka qenë i kufizuar. Duke pasur parasysh faktin se ankesa nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimeve të tilla, ata kanë mbetur të obligueshme dhe përmbaruese në çastin kur u janë dorëzuar palëve.

Në bazë të fakteve, Gjykata vëren se autoritetet nuk kanë ndërmarrë kurrfarë masa për krijimin e kushteve të nevojshme për zbatim të këtyre aktvendimeve, edhe pse kanë qenë të vetëdijshëm për sjelljen jo kooperative të nënës dhe për faktin se ata kanë qenë kompetent të veprojnë edhe në iniciativë të tyre. Për shkak të rrethanave të tilla, aktvendimet e Qendrës për takime kanë mbetur të pa përmbaruara një periudhë të gjatë kohore, gjatë së cilës ankuesit nuk kanë qenë në gjendje që ta takojnë M.M. Gjykata gjithashtu konsideron se autoritetet zyrtare nuk i kanë ndërmarrë të gjitha masat e disponueshme dhe të cilat racionalisht janë pritur nga ana e tyre, për nga aspekti i sigurimit të drejtave të palës ankuese në lidhje me këtë çështje. Edhe

pse Qendra i ka hulumtuar efektet që do të shkaktonte ndarja e vajzës së mitur M.M. nga i ati i saj, Qendra prapëseprapë nuk i ka marrë parasysh interesat legjitime të ankuesve gjatë zhvillimit dhe mirëmbajtjes së lidhjeve me M.M..

Duke pasur parasysh lartpërmendurën, si dhe ndjeshmërinë e materies së shqyrtuar, Gjykata sajton konkludimin se organet vendore nuk kanë bërë orvatje përkatëse dhe efektive për realizimin e të drejtave të palës ankuese, për nga aspekti i jetës së tyre familjare, që është e garantuar me nenin 8 të Konventës.

Në lidhje me shkeljet e theksuara të nenit 13 të Konventës

Për nga aspekti i mjeteve efikase juridike, Gjykata, për rastin konkret vërejtë se pala ankuese i ka shfrytëzuar këto mjete juridike vijuese: ankuesi i parë ka kërkuar nga Qendra për punë sociale dhe nga Ministria për drejtësi që ti përbaroj vendimet e sjella nga Qendra; ai pa sukses ka kërkuar, që në pajtim me nenin 87 të Ligjit për familje, të realizoj përkujdesje të përkohshme familjare mbi fëmijën; ai ka iniciuar procedurën penale kundër zonjës J.S.M., për grabitjen e personit të mitur. Ankuesit, gjithashtu kanë kërkuar ndihmë edhe nga organet tjera vendore.

Gjykata ka vërejtur se kërkesa e ankuesit të parë, për zbatim të vendimeve të miratuara nga Qendra ka qenë e paqëllim. Kjo për arsye se Qendra por edhe Ministria për drejtësi janë shpallur si jo kompetent për të vepruar. Sipas kësaj, sistemi i përbarimit administrativ të vendimeve të organeve të drejtorisë, të theksuar në Ligjin për procedurë drejtuese, nuk ka mundur të vihet në funksion. Në këtë drejtim, Gjykata ka konkluduar se Qeveria nuk i ka dorëzuar Gjykatës kurrfarë dispozita të posaçme të ligjeve ose të praktikës vendore, në aspekt të asaj se cili organ është kompetent për zbatimin e vendimeve të miratuara nga Qendra e që janë në lidhje me gjendjet e konstatuara. Këto çështje mbeten të hapura edhe në lëndën e ankuesve, edhe përkaj mekanizimit për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave në mes organeve drejtuese, të parapara në legjislativin vendor. Në lidhje me përbarimin nga ana e përbaruesve, Gjykata nuk fiton bindjen, e as Qeveria nuk ka dorëzuar kurrfarë komente për të argumentuar përgënjeshttrimin e faktit se mekanizmi i përbarimit, i paraparë me Ligjin për përbarim është zbatuar në vendimet e miratuara nga Qendra. Ky konstatimi është i qëndrueshëm, meqenëse

sistemi ka të bëjë me përmbartimin e aktgjykimeve gjyqësore ose të vendimeve të sjella nga organet drejtuese, lidhur me obligimin materiale, që nuk është edhe rast me vendimet e Qendrës lidhur me takimet.

Në rrethana të tilla, Gjykata nuk mund ti evitoj konstatimet se nuk ka ekzistuar mjet efikas juridik në legjislativin vendor lidhur me ankesat e ankuesve, që janë në lidhje me mos zbatimin e vendimeve të miratuara nga Qendra e që kanë të bëjnë me takimet me M.M.

Më pas, Gjykata vëren se procedurat penale të iniciuara në muajin tetor të vitit 2013, kundër zonjës J.S.M akoma nuk janë të përfunduara para gjykatave vendore. Nuk janë iniciuar kurrfarë procedura për nga aspekti i refuzimit nga ana e saj, që ti respektoj vendimet për takimet e gjyshes dhe gjyshit me vajzën e mitur. Theksimet, por edhe praktika vendore të cilën e dorëzoi Qeveria, nuk mund ta bind Gjykatën se kompensimi përmes procedurës penale, paraqet mjetin efikas juridik në lidhje me të drejtat e ankuesve që janë në pajtim me nenin 8 të Konventës.

Duke pasur parasysh këtë prapavijë, Gjykata konsideron se ankuesve nuk u është ofruar mjeti efikas juridik në lidhje me ankesat e tyre sipas nenit 8 të Konventës. Për këtë arsye, evidentohen shkelje të nenit 13, të shqyrtuar në lidhje me nenin 8 të Konventës.

Ankuesi i parë, ka kërkuar 100.000 euro në emër të dëmit material të shkaktuar nga mos pagesa e pagës, nga e cila ai është privuar gjatë kohës së qëndrimit në shtetin e paditur. Ai gjithashtu ka kërkuar 50.000 euro në emër të dëmit jo material për vuajtjet mentale që i ka përjetuar si rezultat i shkeljeve të lartpërmendura. Ankuesi i dytë dhe i tretë, kanë kërkuar me nga 10.000 euro për dëme të natyrës jo materiale. Qeveria i ka kontestuar kërkesat e ankuesve si të pa baza. Qeveria më pas ka theksuar se nuk ekziston lidhja kauzale në mes dëmshpërblimit të kërkuar dhe shkeljeve të theksuara. Ankuesit, po ashtu kanë kërkuar 11.000 euro për shpenzimet e realizuara para autoriteteve vendore dhe para Gjykatës. Qeveria i ka kontestuar kërkesat e lartpërmendura si të pa baza, duke theksuar se ata nuk kanë dorëzuar kurrfarë dëshmi se shpenzimet e kërkuara kanë qenë "të besueshme dhe të domosdoshme".

Gjykata, duke vendosur në bazë të barabartë, ankuesit të parë i ndau 13.000 euro, kurse ankuesit të dytë dhe të tretë në mënyrë të përbashkët u ndan 7.000 euro, plus pagesën e cilëndo prej taksave që do të duhet të paguhet.

Gjithashtu, Gjykata u përcaktoi edhe shumën prej 850 euro, në mënyrë të përbashkët për tre ankuesit, për shpenzimet e gjeneruar për procedurat para Gjykatës, plus cilëndo prej taksave që do të duhet të paguhet.

III.3 Mitrinovski kundër RM-së, A. nr. 6899/12 (aktgjykimi i GJEDNJ i datës 30 prill të vitit 2015)

Shkelja e nenit 6 paragrafi 1 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (KEDNJ) për nga aspekti se ankuesi nuk ka qenë i marrë në pyetje nga tribunali i paanshëm.

Lënda pason nga aplikimi (nr. 6899/12) i dorëzuar nga ana e shtetasit të Maqedonisë, z. Jordan Mitrinovski ("ankuesit") më 27 janar të vitit 2012. Në ankesën e tij, ai ka theksuar se në pajtim me nenin 6 të Konventës, Këshilli gjyqësor nuk ka qenë "tribunal i pavarur dhe i paanshëm", nëse merret parasysh fakti se kryetari i Këshillit gjyqësorë, i cili ka qenë anëtarë i Komisionit për rastin e tij, si dhe kryetari i Gjykatës supreme, në kërkesë të cilit është iniciuar procedura e kontestuar, në mënyrë suksesive kanë pasur rolin edhe mbi sjelljen e vendimit nga Këshilli gjyqësorë, përmes të cilit ai ka qenë i shkarkuar. Në këtë drejtim, ai gjithashtu ka theksuar se kryetari i Gjykatës supreme, dhe për shkak të faktit se i njëjti edhe më parë ka ndikuar për lejimin e mendimit juridik të sjell nga seksioni penal i Gjykatës supreme, më ka pasur mendim prej më parë të formuluar për qëndrueshmërinë e çështjes, përkatësisht për shkarkimin e tij.

Përkatësisht, në pajtim me faktet e lëndës, më 10 dhjetor të vitit 2010, seksioni penal i Gjykatës supreme, i përbërë prej gjashtë gjykatësve të kësaj gjykate, duke përfshirë edhe gjykatësin J.V. ka mbajtur seancën në të cilën ka konkluduar se dy gjykatësit (prej të cilëve njëri është ankuesi) kanë vepruar në mënyrë joprofesionale. Në parashtrësën e datës së njëjtë, gjykatësi J.V., si anëtarë i Këshillit gjyqësorë sipas detyrës zyrtare, ka kërkuar që Këshilli gjyqësorë të konstatoj veprimin joprofessional në rastin e ankuesit dhe gjykatësit I.L.

Më 23 dhjetor të vitit 2010, në seancën plenare të Këshillit gjyqësorë, duke përfshirë këtu edhe gjykatësin J.V. është debatuar në bazë të kërkesës së gjykatësit J.V., për përcaktim të veprimit jo profesional të ankuesit dhe kërkesa ka qenë e pranuar si kërkesë e dorëzuar në kohë, në tërësi dhe si kërkesë e lejuar. Ata gjithashtu kanë formuar Komisionin për përcaktim të veprimit jo profesional nga ana e ankuesit, "Komisioni" ka qenë i përbërë prej pesë anëtarëve, duke përfshirë edhe kryetarin e Këshillit gjyqësorë. Përbërja e Komisionit nuk përfshirë edhe gjykatësin J.V. Më datë 29 dhjetor të vitit 2010, Komisioni ka dorëzuar kërkesën e gjykatësit J.V. dhe dëshmitë e ofruara deri te ankuesi. Më 18 janar të vitit 2011, ankuesi ka dorëzuar përgjigjen e shkruar dhe ka dorëzuar dëshmi si shtojcë.

Më 23 shkurt të vitit 2010, përbërja plenare e Këshillit gjyqësorë, duke përfshirë këtu edhe gjykatësin J.V., ka iniciuar procedurën për përcaktim të veprimit jo profesional kundër ankuesit dhe në kohë e ka larguar atë nga ushtrimi i funksionit të gjykatësit.

Më 19 prill të vitit 2011, Komisioni ka mbajtur seancë. Sipas procesverbalit të seancës, në të njëjtën ka qenë i pranishëm ankuesi dhe përfaqësuesi juridik i tij, si dhe gjykatësi J.V., në veti të parashtruesit.

Më 18 maj të vitit 2011, seanca plenare e Këshillit gjyqësorë, e cila ka përfshirë edhe gjykatësin J.V., e ka shkarkuar ankuesin nga funksioni i gjykatësit, për shkak të veprimit në mënyrë jo profesionale.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në lidhje me këtë vendim para organit të shkallës së dytë. Ai gjithashtu ka kërkuar edhe përjashtimin e gjykatësit J.V., si dhe të gjithë gjykatësve të Gjykatës supreme.

Në shtojcën ai ka deklaruar se në rastin konkret ekziston ndeshje e interesave, për faktin se gjykatësi J.V., ka kërkuar shkarkimin e tij, dhe më vonë ka votuar për këtë propozim në veti të anëtarit të Këshillit gjyqësorë, sipas detyrë zyrtare. Pozitën që ka pasur ai, ka qenë e llojit të tillë që atij i ka mundur të ushtroj ndikime mbi gjykatësit tjerë të asaj gjykate.

Më 13 shtator të vitit 2011, këshilli ankues ka refuzuar ankesën dhe e ka përdëftuar vendimin e Këshillit gjykues, me të cilin ankuesi ka qenë i shkarkuar nga ushtrimi i funksionit të gjykatësit. Gjithashtu, ka qenë e refuzuar kërkesa e tij për shkarkimin e gjykatësve. Ky këshill ka konstatuar se kompetenca për vendosje në lidhje me kërkesën e ankuesit për shkarkimin e

kryetarit të Gjykatës supreme i përket seancës plenare të Gjykatës supreme, dhe e jo Këshilli ankues. Duke u thirrur në Ligjin për procedurë kontestuese, ky këshill më tej ka refuzuar si të palejuar kërkesën e ankuesit për shkarkimin e të gjithë gjykatësve të kësaj gjykate.

Arsyetimet e GJEDNJ

Gjykata përkujton se konceptet për pavarësi dhe paanshmëri objektive janë në lidhje të afërt, dhe, në varësi prej rrethanave, ato mund të kërkojnë hulumtim të përbashkët. Prapëseprapë, duke pasur parasysh faktet në rastin konkret, Gjykata konsideron se është përkatëse që të hulumtohen konstatimet e këtij titulli përmes prizmit të anshmërisë së potencuar të Këshillit gjyqësorë në lidhje me rolin e gjykatësit J.V., në procedurën e kontestuar. Gjykata përkujton se sipas rregullit, paanshmëria nënkupton mungesën e paragjytimeve ose anshmërisë. Sipas praktikës së implementuar të Gjykatës, ekzistimi i pa anshmërisë për nevojat e nenit 6, paragrafi 1 duhet të përcaktohet sipas (i) testit subjektiv, sipas të cilit mbahet llogari për bindjet personale dhe për sjelljet e ndonjë gjykatësi të caktuar – përkatësisht se vallë gjykatësi ka pasur paragjytime personale ose anshmëri në ndonjë rast të caktuar dhe (ii) testit objektiv, përkatësisht konstatimit se vallë vetë tribunali, dhe, në mes aspekteve tjera, përbërja e tij, ofron garanci të mjaftueshme që të përjashtohet çfarëdo qoftë dyshimi për nga aspekti i paanshmërisë së tij.

Në rastin konkret, Gjykata vëren se sipas Amendamentit XXVIII të Kushtetutës, Këshilli gjyqësorë përbëhet prej pesëmbëdhjetë anëtarëve, prej të cilëve kryetari i Gjykatës supreme dhe Ministri i drejtësisë janë anëtarë sipas detyrës zyrtare; tetë anëtarë zgjidhen nga ana e gjykatësve dhe pesë anëtarë zgjidhen nga ana e Kuvendit. Procedura para Këshillit gjyqësorë për përcaktim të veprimit jo profesional është rregulluar në mënyrë të detajuar në suaza të Ligjit, sipas të cilit përcaktimi i veprimit jo profesional të gjykatësit nga ana e Këshillit gjyqësorë mund të rezultojë vetëm me mënjanimin e atij gjykatësi nga ushtrimi i funksionit të gjykatësit.

Neni 78 (1) i Ligjit, përcakton se çdo anëtarë i Këshillit gjyqësorë, mund të kërkojë nga Këshilli gjyqësorë të konstatojë se vallë ekziston veprimi jo profesional nga ana e gjykatësit. Kërkesa e tillë mund të parashtrohet nga ana e kryetarit të gjykatës më të lartë. Në rastin konkret, gjykatësi J.V., i cili ka qenë kryetar i Gjykatës supreme në atë periudhë kohore dhe anëtarë i

Këshillit gjyqësorë sipas detyrës zyrtare, ka iniciuar procedurën e kontestuar në lidhje me ankuesin, i cili gjatë periudhës ka qenë kryetar i Gjykatës së apelit Shkup.

Kërkesa ka qenë e dorëzuar pasi që seksioni penal i Gjykatës supreme, i cili ka qenë kompetent që të debatoj për çështje proceduese dhe materiale lidhur me lëndët penale, njëzëri ka konstatuar se “ka pasur veprime jo profesionale nga ana e dy gjykatësve”. Gjykatësi J.V., ka marrë pjesë në seksionin penal dhe se ka votuar në favor të këtyre konstatimeve.

Në rrethana të tilla, Gjykata konsideron se ankuesi ka pasur bazë legjitime që të frikohet se gjykatësi J.V., tani më ka pasur bindje personale se si duhet të shkarkohet për shkak të veprimit jo profesional, para se kjo çështje të iniciohet para Këshillit gjyqësorë.

Gjykata më tej, vëren se përbërja plenare e Këshillit gjyqësorë, i cili ka përfshirë edhe gjykatësin J.V., ka vendosur se kërkesa është e qëndrueshme. Me ç’rast është formuar ad – hoc komisioni, si trup i brendshëm i Këshillit gjyqësorë, i cili ka realizuar procedurën e kontestuar. Komisioni ka qenë i përbërë prej pesë anëtarëve të Këshillit gjyqësorë. Gjykatësi J.V., nuk ka qenë anëtarë i këtij Komisioni. Më 19 prill të vitit 2011, Komisioni ka mbajtur seancën në të cilën i ka shqyrtuar dëshmitë relevante dhe i ka dëgjuar argumentet dhe vërejtjet përfundimtare të ankuesit dhe të gjykatësit J.V. Gjykatësit, gjithashtu i është dhënë edhe mundësia që ta marrë në pyetje ankuesin. Edhe ankuesi edhe gjykatësi J.V., e kanë nënshkruar procesverbalit të seancës. Duke i pasur parasysh rregullat proceduese të përshkuara më lartë, Gjykata konsideron se në rastin konkret kundër ankuesit, gjykatësi J.V., ka pasur të drejta si palë gjatë procedurës së kontestuar. Kërkesa e tij ka iniciuar procedurën, në favor të së cilës ai ka dorëzuar edhe dëshmi dhe argumente të cilat janë në favor të pohimeve për veprimit jo profesional nga ana e ankuesit. Në mënyrë përkatëse, ai ka vepruar si “prokurorë” në raport me ankuesin, “të paditurin” në procedurën e kontestuar.

Duke u thirrur në raportin e Komisionit, vendimi i Gjykatës supreme i miratuar në lëndën penale Kszh. nr. 537/2010 dhe konkluzioni i seksionit penal të Gjykatës supreme, përbërja plenare e Gjykatës supreme ka shkarkuar ankuesin për shkak të veprimit jo profesional. Gjykatësi J.V., si anëtarë i Këshillit gjyqësorë sipas detyrës zyrtare, ka marrë pjesë gjatë sajimit të këtij

vendimi. Edhe ankuesit edhe gjykatësit J.V., u është dorëzuar ekzemplar i këtij vendimi.

Në rrethana të tilla, Gjykata konsideron se sistemi në të cilin gjykatësi J.V., si anëtarë i Këshillit gjyqësorë, i cili ka iniciuar procedurën e kontestuar dhe më pas ka marrë pjesë në sjelljen e vendimit që të shkarkohet ankuesi, shton dyshimet objektive për paanshmërinë e tij gjatë vendosjes për qëndrueshmërinë lidhur me rastin e ankuesit.

Në bazë të lartpërmendurës, Gjykata konstatoi se roli i gjykatësit J.V., në procedurën e kontestuar nuk e ka kaluar as testin e subjektivitetit e as testin e objektivitetit. Si argument plotësues theksimet e faktit se gjykatësi J.V., ka qenë vetëm njëri prej pesëmbëdhjetë anëtarëve të Këshillit gjyqësorë, nuk mundet, në rrethana të tilla, të ofroj rezultate më ndryshe. Sipas kësaj, mund të sajohet konkludimi se ekzistojnë shkelje të nenit 6 paragrafi 1 të Konventës, për shkak të mungesës së paanshmërisë së nevojshme të Këshillit gjyqësorë i cili ka debatuar për rastin e ankuesit.

Ankuesi ka kërkuar 34.924 euro për nga aspekti i dëmit material. Kjo shumë ka të bëjë me dallimin e të ardhurave të cilat ai do ti gëzonte si gjykatës. Ai gjithashtu ka kërkuar 50.000 euro si dëmshpërblim jo material për shkeljen mbi nderin dhe autoritetin e tij, si dhe për shqetësimet psikike dhe për cenimet mbi shëndetin e tij. Qeveria i ka kontestuar këto kërkesa dhe ka argumentuar se të njëjtit janë të pa baza. Ajo më tej ka theksuar se nuk ekziston lidhja kauzale në mes dëmit material të theksuar, dhe shkeljeve të potencuar. Ankuesi gjithashtu ka kërkuar 980 euro për shpenzimet juridike për përfaqësimin e tij para autoriteteve vendore. Si argumentim të konstatimeve ai ka dorëzuar edhe fletëpagesën. Për sa i përket shpenzimeve të realizuara për përfaqësim para Gjykatës, ai ka kërkuar 250 euro për shpenzimet postare dhe për shpenzimet për fotokopjime dhe përkthime. Ai ka siguruar edhe kopjet e fletëpagesave dhe faturave.

Gjykata i ndan 4.000 euro për sa i përket dëmit jo material dhe 1.230 euro për shpenzimet, plus cilëndo prej taksave që do të duhet të paguhet.

БИЛТЕН ЗА СУДСКАТА ПРАКТИКА НА ЕВРОПСКИОТ СУД ЗА ЧОВЕКОВИ ПРАВА

Издавач:
МАКАВЕЈ

За издавачот:
Јагода Цветкоска, директор

Превод од англиски јазик:
Наташа Андреевска-Томовска

Корица и техничко уредување:
Кристи Георгиевски

Печати:
Академски печат – Скопје

Тираж:
800 примероци

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Botues:
МАКАВЕЈ

Për botuesin:
Jagoda Cvetkoska, drejtor

Përkthimi në gjuhën shqipe:
Koço Bendo
Behar Dalipi

Kopertina dhe rregullimi teknik:
Kristi Georgievski

Shtypshkronja:
“Akademska pečat” – Shkup

Tirazhi:
800 ekzemplarë